



**Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

**Inputi për Raportin e Progresit**

*Gusht 2013, Prishtinë*

1. KRITERET POLITIKE .....	3
1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT .....	3
1.1.1 Institucionet .....	3
1.1.2 Kuvendi / Zgjedhjet .....	4
1.1.3 Administrata Publike .....	4
1.1.4 Sistemi Gjyqësor.....	5
1.1.5 Politikat kundër korrupsionit .....	7
1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE .....	8
1.2.1 Të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale .....	8
1.2.2 Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve .....	9
1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE .....	11
2. EKRIKTERET EKONOMIKE .....	12
2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT .....	12
2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike .....	12
2.1.2. Raportimi në lidhje me politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese .....	14
2.1.3. Ndërveprimi i forcave të tregut.....	15
2.1.4. Sektori Financiar .....	16
2.2. Kapaciteti për t'u përballuar me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut .....	18
2.2.1. Kapitali njerëzor dhe fizik .....	18
2.2.2. Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve.....	19
2.2.3. Ndikimi i shtetit në konkurrencë/konkurrueshmëri .....	20
2.2.4. Integrimi i tregtisë .....	20
3. STANDARDET EVROPIANE .....	22
3.1. TREGU I BRENDSHËM.....	22
3.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave .....	22
3.1.2. Lëvizja e lirë e kapitalit .....	23
3.1.3. Doganat dhe Tatimet.....	24
a. Doganat.....	24
b. Tatimet.....	24
3.1.4. Konkurrenca .....	25
3.1.5. Prokurimi Publik .....	25
3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit .....	25
3.1.7. Punësimi dhe politikat sociale .....	26
3.1.8. Arsimiti dhe Hulumtimi.....	27
3.2. POLITIKAT SEKTORIALE .....	27
3.2.1. Industria dhe NVM-të.....	27
3.2.2 Bujqësia dhe peshkataria .....	28
3.2.3 Mjedisi .....	30
3.2.4. Politikat e transportit.....	32
3.2.5. Energjia, përfshirë edhe sigurinë nukleare .....	33
3.2.6. Shoqëria Informativë dhe Media.....	34
3.2.7. Kontrolli financiar.....	35
3.2.8. Statistikat.....	35
3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA .....	36
3.3.1. Azili, migracioni, politikat e vizave dhe menaxhimi i kufijve .....	36
3.3.2. Pastrimi i parave .....	38
3.3.3. Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, përfshirë terrorizmin .....	38
3.3.4. Mbrojtja e të dhënave personale.....	40

## **HYRJE**

Raporti përmban zhvillimet kyçe në Kosovë prej datës 1 maj 2013 deri më datën 30 gusht 2013. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e vet që të ofroj të dhënat për këtë periudhë për Raportin e Progresit i cili pritet të publikohet në vjeshtën e këtij viti.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport përqendrohen në progresin e arritur:

- Zbatimin e reformave;
- Zhvillimin e kapaciteteve legislative dhe administrative;
- Sfidat e identifikuar në Studimin e Fizibilitetit të vitit 2012 dhe konkludimet nga takimi për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit të vitit 2013;
- Zbatimi i Planit të Veprimit për MSA.

Strukturimi i të dhënave korrespondon me Raportin e Progresit të Këshillit të Evropës duke ofruar informacione në tre fushat si në vijim: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane.

# 1. KRITERET POLITIKE

## 1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

### 1.1.1 Institucionet

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka vlerësuar dhe miratuar gjithsej tetë (8) Raporte Vjetore të institucioneve të pavarura (agjencive). Për më shumë detaje shih tabelën më poshtë.

Tabela 1: Raportet vjetore të miratuara nga Kuvendi

Data	Raporti
11.06.2013	2012 Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
24.06.2013	2012 Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës
11.07.2013	2012 Raporti vjetor për statusin e Shërbimit Civil në Kosovë
12.07.2013	2012 Raporti vjetor i Agjencionit të Statistikave
17.07.2013	2012 Raporti vjetor i Këshillit Prokurorial të Kosovës
19.07.2013	2012 Raporti vjetor i Agjencionit Kosovar të Privatizimit
22.07.2013	2012 Raporti vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
31.07.2013	2012 Raporti vjetor i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Sa i përket vlerësimit dhe miratimit të ligjeve, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar gjithsej 28 ligje. Aktualisht 22 projektligje janë në procedurë parlamentare. Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi i ka dërguar Ekzekutivit gjithsej 58 procedura të shqyrtimit të hollësishëm parlamentar.

Në lidhje me *koordinimin e çështjeve të integritimeve evropiane*, Ministria e Integritimit Evropian ka vazhduar që të ofroj në mënyrë efektive mandatin e saj në koordinimin e çështjeve të integritimit në BE. Kjo është mbështetur nga lidhshipi i fortë politik i MIE-së dhe kapacitetet teknike dhe administrative të efektshme. Janë organizuar me sukses takimet e rregullta të DPSA-së, në korrik u mbajt një takim plenar.

Struktura e re MIE-së është plotësisht e funksionalizuar. Nën udhëheqjen e MIE-së, si dhe me mbështetjen e KE-së dhe SIGMA-së, ka nisur një projekt twinning light mbi vlerësimin e kapaciteteve institucionale të MIE-së, të gjitha departamenteve qeveritare për çështje ligjore dhe të departamenteve për integrim evropian.

MIE-së ka vazhduar të përgatisë raporte të rregullta mbi zbatimin e Planit të Veprimit për MSA-në. Marrëdhënia në mes të Zyrës për Planifikim Strategjik dhe Ministrisë së Financave ka vazhduar të përmirësohet, në veçanti gjatë përgatitjes së buxhetit kombëtar të vitit 2013 dhe kontributin e Kosovës për IPA Dokumenti Strategjik Vendor .

Institucionet e Kosovës në udhëheqjen e MIE-së, me sukses kanë koordinuar kontributin e Kosovës gjatë përgatitjes së IPA instrumentit të ri dhe DSV-së.

Struktura ndërministrrore e integritimit evropian ka vazhduar të luaj rol të thelbësor në koordinimin e çështjeve ndërministrrore; në veçanti është forcuar roli i Këshillit Ministror për Integritime Evropiane.

MIE ka nisur me sukses përgatitjet për fillimin e negociatave për MSA me themelimin e strukturave koordinuese ndër-institucionale dhe me përgatitjen e analizimit të MSA-ve të regjionit.

Janë aprovuar instrumentet e reja që udhëheqin harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së. Instrumentet e reja kanë prezantuar tabelën e përputhshmërisë, deklaratën e kompatibilitetit dhe opinionin e kompatibilitetit. Aplikimi i tyre do të filloj me 1 janar të vitit 2014. Njëkohësisht janë duke organizuar masat për ngritje të kapaciteteve.

Gjatë periudhës së raportimit me qëllim të promovimit të ngritjes së konsensusit lidhur me çështjet e integritimit evropian. Task forca për integritime evropiane ka hartuar Strategjinë për Integritim Evropian. Për këtë qëllim, janë mbajtur dhjetëra takime me pjesëmarrjen e më shumë se 1000 zyrtarëve, ekspertëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, publikut, studiuesve

akademik, përfaqësuesve të komunitetit dhe organizatave ndërkombëtare

### 1.1.2 Kuvendi/ Zgjedhjet

Me datën 2 korrik 2013, Kryetarja e Republikës së Kosovës ka shpallur 3 nëntorin si datë zyrtare për mbajtjen e zgjedhjeve lokale. Dy ditë më vonë, me 4 korrik 2013 Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) menjëherë aprovoi Planin Operativ për zgjedhjet lokale dhe si rrjedhojë i caktoi Sekretariatit të KQZ-së detyrën për zbatimin e planit të lartpërmendur.

Në përputhje me kompetencat e dhëna me anë të Nenit 64.2 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, KQZ-ja ka aprovuar vendimet si në vijim:

- Kufizimin e shpenzimeve financiare të përdorura gjatë fushatës për zgjedhjet lokale, me datën 8 korrik 2013;
- Dizajnimin e shenjës identifikuese për vëzhguesit e zgjedhjeve lokale, me datën 10 korrik 2013;
- Strategjinë për informim të publikut për Zgjedhjet Lokale; me datën 12 korrik 2013;
- Organogrami për stafin jo permanent për zgjedhjet lokale, me datën 16 korrik 2013;
- Planin operativ të C&CR për zgjedhjet lokale; me datën 16 korrik 2013;
- Themelimin e Bordit Mbikëqyrës për Informim Publik; me datën 16 korrik 2013;
- Kodin e mirësjelljes për anëtarët e KZK-së për zgjedhjet lokale; me datën 17 korrik 2013;
- Emërimi i anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Komunal në 38 komuna, me datën 17 korrik 2013;
- Caktimin e 58 qendrave të reja të votimit, me datën 30 korrik 2013;
- Specifikacionet teknike (dizajnin dhe formatin e fletëvotimit), me datën 30 korrik 2013;
- Kategorizimin e materialit të ndjeshëm që do të përdoret gjatë zgjedhjeve, llambat ultraviolete dhe sprejin e padukshëm, me datën 15 gusht 2013.

Krijimin e mundësisë për votuesit e verbër dhe votuesit me shikim të dobësuar që personalisht të votojnë, me datën 26 gusht 2013.

### 1.1.3 Administrata Publike

Në qershor të vitit 2013 MAP-ja aprovoi raportin e realizimit të strategjisë së RAP-it. Bazuar në këtë raport vlerësim është gjetur se 52% e Planit të Veprimit ishte realizuar. Në mënyrë që të përmbushë objektivat e para-përcaktuara, tashmë është duke u hartuar një udhërrëfyes i rishikuar për zbatimin e strategjisë. Ky udhërrëfyes i rishikuar pritet të finalizohet deri kah fundi i vitit 2013.

Gjatë periudhës raportuese DMRAP-ja ka vlerësuar në total 15 Plane Zhvillimore Strategjike. Ndërsa, gjatë periudhës raportuese Qeveria i ka aprovuar Strategjitë dhe PV-të si në vijim:

- Strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013-2022 dhe PV-ja për Mjedisin 2013-2017, me datën 17 korrik 2013;
- Strategjia dhe PV-ja për bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile 2013-2017, me datën 5 korrik 2013;
- Plani Vjetor i Veprimit 2014 për Statistikat, me datën 3 korrik 2013;
- Strategjia për të drejtat e njeriut, me datën 26 qershor 2013.

Për më tepër me datë 28 gusht 2013 u mblodh KNMRAP-ja.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar, me datën 17 korrik 2013, Ligjin për Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP)

Për më tepër, sa i përket rregullores për organizimin e brendshëm, statusi aktual për ministritë e linjës është si në vijim:

- Ministria e Integritimit Evropian – e aprovoi në dhjetor të vitit 2012, është në proces të amandamentimit. Me datën 6 gusht 2013 MAP-ja e ka aprovuar dhe modifikuar rregulloren dhe e ka dërguar për miratim në qeveri;
- Ministria e Shëndetësisë – e miratuar më datën 24 prill 2013 me anë të Vendimit të Qeverisë nr. 03–127;
- Ministria e Drejtësisë - e miratuar nga MAP-ja me datën 17 qershor 2013;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë - e miratuar nga MAP-ja me datën 29

korrik 2013;

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – e miratuar nga MPA-ja me datën 6 gusht 2013;
- Ministria e Diasporës – e miratuar nga MAP-ja me datën 29 korrik 2013;
- Ministria e Administratës Publike – e ka dërguar për miratim qeveritar;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – është në MAP;
- Ministria e Punëve të Brendshme është në proces të adresimit të komenteve të bëra nga DMRAP-ja;
- Ministria për Zhvillim Ekonomik është në fazën e adresimit të komenteve të bëra nga DMRAP-ja;
- Ministria e Financave është në fazën e adresimit të komenteve të bëra nga DMRAP-ja;
- Ministria e Infrastrukturës është në fazën e adresimit të komenteve të bëra nga DMRAP-ja.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM) pas vlerësimit të tre ankesave të paraqitura nga mediat kundër vendimit të Komisionit të KPM-së është marr me këtë rast në mënyrën si më poshtë:

Rasti 1 - Operatori Eagle – për dështim që të jetë në përputhje me kushtet e marrëveshjes për Licencë, bordi për ankesa ka vendosur që vendimi fillestar i marr nga komisionin i KPM-së është i vlefshëm; veçanërisht shuma prej 60.000€ ende duhet të paguhet nga operatori Eagle.

Rasti 2 - Operatori IPKO – për dështim që të jetë në përputhje me Ligjin për KPM-në, këshilli e ka vlerësuar vendimin e marr nga Komisioni i KPM-së dhe ka vendosur që të e modifikoj atë vendim dhe si pasoj e ka ulur tarifën e ndëshkimit që do të paguhet nga operatori IPKO, nga 45.000€ në 35.000€.

Rasti 3 - RTV 21 – për dështim që të jetë në përputhje me Rregulloren e Komunikimit Audio-vizual Komercial, këshilli e ka vlerësuar vendimin e marr nga Komisioni i KPM-së dhe ka vendosur që të e modifikoj atë vendim dhe si pasoj e ka ulur tarifën e ndëshkimit që do të paguhet nga RTV 21 nga 15,000 € në 10,000€.

## 1.1.4 Sistemi Gjyqësor

### Reformimi i sistemit gjyqësor

Në mënyrë që të sigurohet një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse në fushën e **gjyqësorit**, ligjet si në vijim janë aprovuar nga Kuvendi::

- Ligji për Avokaturën Shtetërore, i miratuar nga Kuvendi me datën 2 Maj 2013;
- Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, i miratuar nga Kuvendi me datën 18 gusht 2013;

Legjislacioni për funksionimin e sistemit gjyqësor të reformuar, përkatësisht Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorinë, Ligji për KGJK-në dhe Ligjin për KPK-në janë në procesin e rishikimit. Mes të tjerash, paketa e rishikuar e gjyqësorit do të sigurojë përputhje me rekomandimet e Venecias dhe në të njëjtën kohë do të ulë kriteret e përzgjedhjes për gjyqtarët dhe prokurorët, në mënyrë që të përfshijë profesionistët e rinj në sistemin gjyqësor.

Përveç kësaj, KGJK-ja, KPK-ja, MD-ja dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit janë në fazat e fundit të përgatitjes së Vlerësimit të reformës gjyqësore që do të përfundohen deri në nëntor të vitit 2013.

Sa i përket ndërmjetësimit gjatë periudhës raportuese, MD-ja ka pranuar 100 raste, nga të cilat 77 raste janë të referuara nga gjykatat, 22 nga zyrat e prokurorive dhe 1 rast është referuar nga palët, shumica e rasteve janë çështje civile, ndërsa dy prej tyre ishin çështje penale.

Duke synuar reduktimin e rasteve të akumuluar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është në procesin e rishikimit të Strategjisë për zvogëlimin e numrit të lëndëve të mbetura e cila do të miratohet deri në tetor të vitit 2013. Strategjia e re e rishikuar do të përfshijë të gjitha rastet e mbetura dhe rastet para- vitit 2010 të cilat nuk janë zgjidhur me strategjinë e mëparshme.

Ndërsa sa i përket zbatimit të ish strategjisë për rastet e mbetura, bazuar në vlerësimin e zbatimit të strategjisë, është arritur progres i konsiderueshëm. Numri i përgjithshëm i rasteve të pagzjidhura është

zvogëluar për 65,12%, ndërsa 63512 (39.38%) raste mbeten të pazgjidhura.

Tabela 2: Statistika lidhur me rastet e ekzekutuara të viteve 2011 dhe 2012:

Viti	Rastet e trashëguara	Rastet e pranuar	Total në punë	Rastet e zgjidhura	Shkalla e efikasitetit
2011	93882	25505	119387	18894	74,08 %
2012	100493	23585	124078	23937	101,49 %

Sa i përket bashkëpunimit me EULEX-in, takimi BPKSL-së, që u mbajt në maj, miratoi Raportin e NJFK-së Mësimet e Nxjerra dhe vuri re fillimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Përcjelljen e të Burgosurve në pjesën veriore të Mitrovicës, si dhe Udhërrëfyesin për Mbrojtje të Dëshmitarëve. Ndërsa në pasim të takimit të BPKSL-së, Kosova do të sigurojë një vlerësim të pavarur të kapaciteteve lokale të Departamentit të Mjekësisë Ligjore që do të kryhet nga një akter kredibil ndërkombëtar. Përveç kësaj KPK-ja ka lëshuar një vendim për fillimin e procedurave për transferimin e pesë prokurorëve në PSRK. Ky transferim do të kryhet deri më 15 shtator të vitit 2013.

Në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin dhe që të inkurajoj pjesëmarrjen e komunitetit pakicë për pozitat e lira prokuroriale, KPK-ja, nga 14 shkurti deri me 11 qershor 2013, ka organizuar fushata ndërgjegjësuere në zonat e mëposhtme të populluara nga komunitetet pakicë: Graçanicë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Novobërdë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Viti, Gjilan, Kamenicë, Pejë, Istog, Klinë, Mamushë, Prizren., Dragash, Shtërpçë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Vushtrri.

Në mënyrë që të sigurojë ekuilibrin ndëretnik në gjyqësi, KGJK-ja ka bërë përpjekje të vazhdueshme në përmbushjen e pozitave të lira për gjyqtarë nga komunitetet pakicë. Në këtë drejtim i gjithë legjislacioni ka paraparë kriteret për grupet e pakicave, dhe KGJK-ja ka rezervuar pozitat e lira për ta. Dialogu me Serbinë për zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve përfshiu edhe sektorin e drejtësisë. Përfshirja e strukturave ilegale të veriut të Mitrovicës në sistemin gjyqësor të Kosovës ishte në mesin e temave të diskutuara. Marrëveshja do të lehtësojë përfshirjen e minoritetit serb në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

Në kontekst të ofrimit të sigurimit dhe të sigurisë për prokurorët, gjykatësit, familjet e tyre dhe punonjësve të tjerë brenda fushë-veprimtarisë gjyqësore, më 28 qershor 2013 KGJK-ja dhe PK-ja ka nënshkruar një MM mbi sigurimin e mbrojtjes individuale për gjyqtarët.

Për më tepër, KGJK-ja ka miratuar tri akte të brendshme për sigurinë e gjykatave dhe gjykatësve

- UA për Sigurinë e Gjykatave;
- UA për procedurat për ofrimin e sigurisë për gjykatësit;
- UA për instalimin dhe përdorimin e video regjistrimeve brenda gjykatave.
- Ndërsa, KPK-ja ka miratuar dokumentet si në vijim:
- Udhëzim Administrativ mbi Sigurinë e Prokurorëve dhe stafit të zyrës së prokurorisë, e miratuar me datën 19 qershor 2013;
- Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për sigurinë individuale për prokurorët, e miratuar me datën 19 qershor 2013.

Për sa i përket masave disiplinore, gjatë periudhës raportuese, KPK-ja ka pranuar 4 raste disiplinore, nga të cilat dy raste janë zgjidhur, ndërsa dy raste janë në proces të hetimit. Ndërsa KGJK-ja trajtuar 14 raste disiplinore gjatë periudhës raportuese: në pesë raste nuk u gjet shkelje disiplinore, gjashtë qortime, dy vendime për uljen e pagës me 50% për një periudhë gjashtë mujore, dhe një kërkesë për evidencë shtesë.

Me qëllim të përmirësimit të sistemit për menaxhimin e lëndëve në gjyqësi, më 15 korrik 2013 KGJK-ja nënshkroi një marrëveshje me Qeverinë Norvegjeze mbi Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve që pritet të vendoset në sistemin e drejtësisë.

Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese, IGJK-ja ka organizuar sesione të specializuara trajnimiti për gjykatës dhe prokurorë në çështjet që lidhen me zbatimin e reformës gjyqësore. Për më shumë informacion ju lutem referojuni Aneksit 5: sesioneve trajnuese të ofruara nga IGJK-ja dhe AKK-ja.

### Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar

Për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, më 31 korrik të vitit 2013 Kuvendi miratoi Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar. Ligji është vlerësuar të jetë në përputhje me *acquis* të BE-së, në këtë mënyrë plotëson kriteret e përcaktuara në dialogun e vizave.

Sa i përket zbatimit të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, marrëveshjet e mëposhtme me Italinë janë ratifikuar, (19 qershor, 2013):

- Marrëveshje mes Kosovës dhe Italisë mbi ekstradimin dhe depërtimin e personave të dënuar;
- Marrëveshje mes Kosovës dhe Italisë për asistencë reciproke ligjore në çështjet penale.

Marrëveshja me Gjermaninë mbi bashkëpunimin gjyqësor është në pritje të përfundimit, ndërsa marrëveshjet janë duke u negociuar me Malin e Zi, Slloveninë dhe Kroacinë. Përveç kësaj negociatat me Hungarinë, Austrinë, Bullgarinë dhe Katarin pritet të fillojnë së shpejti.

Gjatë periudhës raportuese, Ministria e Drejtësisë ka shkëmbyer në total 1.620 kërkesa për informacion. Në këtë drejtim, autoritetet e Kosovës kanë dërguar shtatë kërkesat për ekstradim, ndërsa ka marrë një.

### Konfiskimi i aseteve

Për konfiskimin e aseteve, AMASK-u në përputhje me mandatin e saj ka intensifikuar aktivitetet e saj për zbatimin e vendimeve të lëshuara nga autoritetet kompetente për konfiskimin e aseteve. Gjatë periudhës raportuese, AMASK-u ka realizuar të ardhura në shumë prej 1,061,024.20€.

Për sa i përket të dhënave të KPK-së për urdhrin për konfiskimin e aseteve, ju lutem referojuni Aneksit 9, Fleta (faqja): 'Konfiskimi i aseteve'. Në mënyrë që të përmirësojë kushtet e punës për ruajtjen e aseteve të konfiskuara, më 13 qershor të vitit 2013 Ministria e Drejtësisë ka siguruar një objekt i cili do të krijojë kushte më të mira për menaxhimin dhe konfiskimin e pasurisë

### **1.1.5 Politikat kundër korrupsionit**

Në mënyrë që të sigurohet një kornizë e duhur ligjore në përputhje me legjislacionin e BE-së në fushën e korrupsionit, më 31 korrik të vitit 2013 kuvendi miratoi Ligjin për Financimin e Partive Politike. Gjatë procesit të hartimit, institucionet e Kosovës kanë marrë parasysh dhe kanë inkorporuar rekomandimet e KE-së lidhur me këtë ligj, adresimin e transparencës së donacioneve nga subjektet juridike; sigurimin e mallrave dhe shërbimeve në administratën publike, dhe detyrimin e partive politike për hapjen e një llogarie të vetme bankare dhe përcaktimin e afateve për botimin e mekanizmit financiar për hetim të sërishëm mes AKK-së dhe institucioneve për zbatimin e ligjit.

Ndërkohë, ligjet në vijim të përcaktuara për të përmirësuar më tej kornizën ligjor kundër korrupsionit do të ndryshohen dhe të miratohen në vjeshtë e vitit 2013:

- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave të personave që ushtrojnë funksione publike;
- Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë zyrtarët publikë.

Ndryshimet e ardhshme do të marrin parasysh përafrimin e dispozitave të tyre me Kodin Penal, duke parashikuar ekzekutimin e sanksioneve më bindëse dhe proporcionale, duke siguruar që veprat penale të ndërlidhura me korrupsion të penalizohen, ndërsa në të njëjtën kohë duke respektuar praktikën më të mira të BE-së.

Në aspektin e zbatimit të ligjeve kundër-korrupsionit, më 6 qershor të vitit 2013 Kuvendi miratoi Raportin Vjetor 2012 të AKK-së, ndërsa më 13 gusht të vitit 2013 AKK-ja ka publikuar Raportin tremujor mbi Zbatimin dhe Monitorimin e Strategjisë Anti-Korrupsion dhe Planin e Veprimit 2013 – 2017.

Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese, AKK-ja ka proceduar 11 raste të ndërlidhura me konfliktin e interesit. Nga ky numër, AKK-ja ka lëshuar 9 opinione për zgjidhjen e konfliktit të interesit, tre opinione ligjore dhe një kërkesë për shkarkimin. Në lidhje me deklarimin e pasurisë, AKK-ja ka nisur 30 padi penale kundër 30 zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk



arritën të raportojnë pasuritë e tyre.

Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit, ju lutem referojuni Aneksit 6: Trajnimet e parashikuar nga IGJK-ja dhe AKK-ja, në fushën e korrupsionit', maj-gusht 2013.

## **1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE**

### **1.2.1 Të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale**

Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon angazhimin e saj për plotësimin e kornizës së nevojshme ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në përputhje me standardet ndërkombëtare. Si pjesë e këtij angazhimi, draft ligjet në vijim janë inkorporuar në Planin Legjislativ të vitit 2013:

- Projektligji për ndryshimin e Ligjit për Barazi Gjinore;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër Diskriminimit;
- Projektligji për Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, që do të miratohet deri në fund të nëntorit;
- Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, që do të miratohet deri në fund të nëntorit.

Në këtë drejtim, Qeveria po asistohet nga një projekt i përbashkët i BE-së dhe KE-së që pritet të formulojnë një propozim të reformës që ofron rekomandime për të lehtësuar strukturën institucionale dhe numrin e shumtë të organeve jo-gjyqësore që merren me të drejtat e njeriut. Në vazhden e kësaj, Qeveria do të miratojë Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe projektligjin për Barazinë Gjinore pasi që të gjitha rekomandimet e ekspertëve të Këshillit të Evropës të jenë pranuar dhe inkorporuar plotësisht.

Për më tepër, janë shënuar përmirësime të mëtejshme në fushën e të drejtave të njeriut, në lidhje me të drejtat e punës. Në këtë drejtim, Kuvendi ka miratuar Ligjin mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë me datën 13 maj 2013 dhe ligji është vlerësuar të jetë në përputhje me direktivat e i BE-së.

Përveç kësaj, strategjitë dhe planet e veprimit në vijim janë miratuar:

- Strategjia kombëtare mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2013-2015 (22 gusht 2013);
- Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë kombëtare mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2013-2015 (22 gusht 2013);
- Strategjia dhe plani i veprimit për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile 2013-2017 (05 korrik 2013);
- Plani i veprimit dhe procedurat standarde në trajtimin e rasteve të dhunës në familje (15 korrik 2013);
- Raporti i progresit mbi të drejtat e fëmijëve me qëllim të vlerësimit dhe monitorimit e zbatimit të strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit mbi të drejtat e fëmijëve (qershor 2013);

Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdon rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të saj; rrjedhimisht 10 anëtarë të stafit u trajnuan për ngjarje të jashtëzakonshme. Përveç kësaj, si pjesë e luftës kundër abuzimit të autoritetit të stafit, SHKK-ja ka imponuar dy (2) masa disiplinore, një (1) njëri mori një njoftim anulim dhe tjetri ka marrë një masë disiplinore të reduktimit të pagës me 20%.

Personat e zhdukur të vazhdojë të trajtohet si një fushë delikate nga institucionet e Kosovës. Komiteti i Kryqit të Kuq ka dorëzuar një përgjigje, të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Arkivave të Kosovës, tek një delegacion nga Beogradi për të tri raste të iniciuara.

Sa i përket dhunës në familje, ka filluar të zbatohet një projekt për themelimin e bazës së të dhënave, i cili përfshin të gjitha rastet e dhunës në familje për vitin 2012. Sa i përket hetimit të rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, gjatë periudhës raportuese, gjykatat e Kosovës dhe Departamentet e Krimeve të Rënda të Zyrave të Prokurorisë Themelore kanë paraqitur statistikat e mëposhtme:

Tabela 3: KPK statistika mbi rastet e dhunës në familje

Statusi i rasteve	Nr. i rasteve	Nr. i personave të përfshirë
Trashëguara	170	246
Pranuara	1051	1544
Zgjidhura		740*
Pazgjidhura	688	1050

\* Ju lutem vëreni se KPK-ja falë rasteve të zgjidhura bazuar në persona të përfshirë

Tabela 4: KGJK- statistika mbi rastet e dhunës në familje

Statusi i rasteve	Nr. i rasteve
Trashëguara	306
Pranuara	7
Zgjidhura	28
Pazgjidhura	285

Në lidhje me të drejtat pronësore, QK-ja ka ranë dakord se mandati i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) duhet të zgjatet për një periudhë përfundimtare deri në vitin 2016 dhe të krijojë një panel të dytë AKP-së për ankesa deri në verën e vitit 2013, Qeveria është zotuar të ndajë burimet e nevojshme për këtë qëllim.

Gjatë periudhës raportuese maj-gusht 2013, janë shqyrtuar 1750 kërkesa. Pra, në shqyrtimin e ankesave të ndërlidhura me AKP-në, është arritur progres i dukshëm me 3,500 ankesa, që duhet të shqyrtohen. Përveç kësaj për shqyrtimin e ankesave të pranuar, AKP-ja është duke punuar edhe në zvogëlimin e lëndëve të mbetura dhe zbatimin e vendimeve të marra. Ndërsa në lidhje me ekzekutimin e vendimeve, 2406 vendime u janë dërguar palëve dhe 2422 vendime janë duke u zbatuar. Përveç kësaj, një anëtar vendor i Komisionit të Ankesave Pronësore të Kosovës, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është riemëruar.

Për më tepër, gjatë periudhës raportuese statistikat e mëposhtme janë paraqitur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës sa i përket numrit të vendimeve gjyqësore dhe administrative të zgjidhura në fushën e të drejtave pronësore:

Tabela 5: Statistika e KGJK-së për ankesat e të drejtave pronësore

Statusi i rasteve	Nr. i rasteve
Trashëguara	32
Pranuara	9
Zgjidhura	12
Pazgjidhura	29

## 1.2.2 Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve

Këshilli për zbatim dhe monitorimi tashmë është funksional dhe ka mbajtur 5 takime ku janë diskutuar çështje të ndryshme në lidhje me mbrojtjen e Kishës Ortodokse, dhe veçanërisht çështje të lidhura me kontestet pronësore.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka miratuar Udhëzimet për vlerësimin e përfshirjes dhe integritimit të trashëgimisë kulturore në planifikimin urban dhe hapësinor të nivelit lokal.

Gjithashtu, përpjekje të mëtejshme janë vërejtur në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së gjuhëve zyrtare dhe statusit të barabartë të tyre në Kosovë. Zyra e Komisionarit të Gjuhëve tashmë është funksionale, gjysma e stafit është rekrutuar dhe filloi të punojë si dhe për pjesën tjetër të stafit zyra është duke pritur njohjen e diplomave serbe të marra në veri të Mitrovicës. Faqja e internetit e Zyrës është tashmë funksionale si dhe janë organizuar aktivitete të ndryshme, të tilla si: një tryezë të rrumbullakët mbi "fushatën e ndërgjegjësimit publik për të mbështetur zbatimin efektiv të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve që promovon të drejtat e njeriut dhe që kontribuon në përfshirjen e pakicave". Për më tepër, u organizua një seminar për ndarjen e praktikave më të mira dhe sfidave që lidhen me zbatimin e politikave gjuhësore në Kosovë.

Deri tani stafi ka marrë pjesë në tre trajnime, njëri prej tyre u mbajt në Irlandë dhe dy të tjerët ishin të organizuara nga IKAP-ja.

Për më tepër, transmetimi në gjuhën serbe ka filluar tashmë në RTK 2, megjithatë ai është ende në fazën eksperimentale.

Ministria për Kthim dhe Komunitete vazhdon mbështetjen e saj për të kthyerit. Gjatë periudhës së raportimit janë ndërtuar 26 shtëpi për të kthyerit. Për më tepër, si pjesë e projektit "Stabilizimi dhe Ri-integrimi i komuniteteve III" janë ndërtuar 17 shtëpi dhe 20 të tjerë janë në ndërtim e sipër në komunën e Prizrenit, Suharekës, Shtërpcë, Parteshit dhe Novobërdës.

Numri i të kthyerve gjatë periudhës raportuese është 258 persona (përfshirë edhe personat nga të gjitha komunitetet).

Me qëllim të krijimit të kushteve për integrimin e të kthyerve, MKK-ja gjatë periudhës raportuese ka realizuar projektet e mëposhtme:

- Asfaltimi i rrugës në fshatin Manastrica, Komuna e Prizrenit;
- Ndërtimi i 9 terreneve sportive për fëmijët në Komunën e Shtërpcës;
- Ndërtimi i rrugës në Vitomiricë, Komuna e Pejës, në Preoc-Uglar, Komuna e Fushë Kosovës Kosova dhe Grençare, Komuna e Kllokotit;
- Rregullimi i pompave të ujit në Bablakë, Komuna e Ferizajt.

Për më tepër, këto projekte janë zbatuar nga MKK-ja, si pjesë e kthimit të komuniteteve dhe ri-integrimit:

- Mbështetje për 37 projekte të OJQ-ve (136.641 €);
- Furnizimi i 234 familje me material ndërtimor (894.279 €);
- Shpërndarja e pakove higjienike, pakove ushqimore dhe orendive shtëpiake (17.701 €);
- Shpërndarja e pajisjeve bujqësore (239.313 €).

Si pjesë e përfshirjes së komuniteteve pakicë në administratën publike, MPA-ja ka raportuar në vijim numrin e komuniteteve pakicë të punësuar në administratën publike:

Tabela 6: Statistikat e punësimit të MPA-së në bazë të etnisë

Kombësia	Nr. i punëtorëve
Shqiptarë	64954 (90,08%)
Serb	4601 (6,38%)
Boshnjak	1364 (1,89%)
Turq	724 (1,0%)
Goran	72 (0,1%)
Ashkalinj	120 (0,16%)
Egjiptian	65 (0,09%)
Romë	136 (0,18%)
Të tjerë	68 (0,09%)

Sa i përket hetimeve të rasteve me motive etnike dhe fetare, Gjykatat për krimet në Kosovë dhe Departamentet e Krimeve të Rënda të Zyrave të Prokurorisë Themelore kanë paraqitur statistikën e mëposhtme:

Tabela 7: Statistika e KGJK-së të rasteve të shqyrtuara penale me motiv etnik, janar-qershor 2013

Statusi i rasteve	Nr. i rasteve
Trashëguara	2
Pranuara	3
Zgjidhura	2
Pazgjidhura	3

Tabela 8: Statistika e KPK-së të rasteve të shqyrtuara penale me motiv etnik, janar-qershor

Statusi i rasteve	Nr. i rasteve
Trashëguara	3
Pranuara	1
Zgjidhura	1
Pazgjidhura	3

Ndërkohë, PK-ja gjatë periudhës raportuese ka raportuar 4 raste të krimeve të motivuara etnikisht, më së shumti përbëhen nga lëndimet të lehta trupore dhe nxitje të urrejtjes, të cilat gjithashtu janë duke u hetuar.

### 1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE

Qeveria e Republikës së Kosovës më 5 prill të vitit 2013 vendosi të ndajë 40.000 € për përmbushjen e kontributit financiar vjetor 2013 të KBR-së. Asnjë vendim i tillë nuk mor në vitin 2012 për shkak të qëndrimit të mëparshëm Koordinatorit kombëtar të KBR-së lidhur me statusin e KBR-së që është mos përfshirja e Kosovës si anëtare e barabartë.

Më 30 maj të vitit 2013 KBR-ja mbajti takimin vjetor në Ohër të Maqedonisë. Kosova si anëtare e re e KBR-së u përfaqësua nga ambasadori i saj në Maqedoni për shkak të faktit se aktualisht Kosova nuk ka një koordinator kombëtar për KBR-në. Gjatë këtij takim u miratua Raporti Vjetor i KBR-së 2012-2013 si dhe Strategjia e Programit të Punës të KBR-së 2014-2016.

## 2. EKRIKTERET EKONOMIKE

### 2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT

Qeveria e Kosovës ka vazhduar zbatimin e politikave të kujdesshme për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale. Vendimet e fundit të politikës fiskale kanë qenë të fokusuara drejt qëllimit të njëjtë.

Në qershor të vitit 2013, FMN-ja ka kryer rishikimin e katërt të ecurisë ekonomike të Kosovës në bazë të marrëveshjes Stand-By (SBA), ku u diskutua mbi Nenin IV. Misioni i nivelit teknik ka vlerësuar pozitivisht performancën makroekonomike të vendit. Të gjitha kriteret sasiorë të performancës dhe standardet strukturore janë përmbushur, duke përfshirë qëndrueshmërinë fiskale, bilancin e përgjithshëm bankar të qeverisë dhe forcimin e sistemit financiar. Përfundimi i suksesshëm i këtij rishikimi mundëson që Kosova të tërheqë 4.251.000 SDR (rreth 5.000.000 €). Megjithatë, Qeveria e Kosovës ka vendosur që të trajtojë marrëveshjen si parandaluese në vitin 2013, kështu që nuk ka në plan që të tërheq këtë shumë.

Zhvillimet fiskale kanë qenë përgjithësisht në linjë me trajektoren e synuar për ekzekutimin e buxhetit. Qeveria e Kosovës dhe misioni i FMN-së kanë dakord për finalizimin e amendamentit të kornizës së bazuar në rregulla fiskale, e cila është miratuar nga Kuvendi në fillim të muajit të kaluar. Rregulli ligjor detyruar fiskale do të zbatohet në vitin 2014. Qeveria gjithashtu ka përgatitur projekt-propozim për kornizën e bazuar në rregulla për përcaktimin e nivelit të pagës minimale. Autoritetet dhe misioni gjithashtu kanë rënë dakord në parametrat e gjera të buxhetit të vitit 2014 të bazuar në rregulloren fiskale. Shqyrtimi i pestë pritet të mbahet në tetor të vitit 2013 pasi që programi i FMN-së SBA pritet të përfundojë kah fundi i vitit 2013. Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për të arritur objektivat e programit, ndërsa në të njëjtën kohë të ruaj stabilitetin makro-fiskal dhe financiar.

#### 2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike

Edhe pse në një shkallë më të kufizuar, kriza e eurozonës ka transmetuar efektet e saj në Kosovë. Niveli i ulët i integritimit të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar dhe niveli i ulët i borxhit publik kanë kontribuar për një ndikim të tërthortë të krizës në ekonominë e Kosovës, kryesisht nëpërmjet lëvizjeve të çmimeve ndërkombëtare për metalet dhe rënie e kërkesës globale. Bazuar në të dhënat paraprake për fundin e vitit 2012, PBV-ja reale vlerësohet të jetë rritur me 2.4%. Një rënie e konsumit dhe eksporteve ka kontribuar negativisht në ngadalësimin e rritjes së prodhimit. Ndërsa, investimet e përgjithshme, eksporti i shërbimeve dhe importet e ngadalshme të mallrave dhe shërbimeve kanë kontribuar pozitivisht në rritjen e prodhimit.

Rritja në vitin 2013 është vlerësuar të jetë rreth 3.7%. Rritja pritet të jetë nxitur nga eksportet e mallrave, shërbimeve dhe investimeve private. Importi i mallrave të konsumit u rrit me 2.6% në gjysmën e parë të vitit, në kontrast me një rënie prej 0,02% në vitin e kaluar. Importi i mallrave të konsumit paraqet një indikator të rëndësishëm të zhvillimeve të konsumit të brendshëm, edhe pse një zëvendësimi i importeve me produkte vendore është vërejtur në kohët e fundit, veçanërisht në sektorin e bujqësisë. Këto zhvillime sinjalizojnë një rritje të arsyeshme prej 3.7% të konsumit privat. Kjo është mbështetur edhe nga rritja e remitancave nga 15.5% në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, importi i mallrave të investimeve (si një masë e nivelit të investimeve në vend), është rritur me 5.7% në gjysmën e parë të vitit duke sinjalizuar zhvillime pozitive të tendencave të investimeve të përgjithshme në Kosovë. Rënia në çmimet ndërkombëtare të materialit ndërtimor ka kontribuar në rritjen e investimeve në terma real. Investimet private ka qenë kontribuuesi kryesor që shkalla e ekzekutimit të investimeve publike ka qenë e ulët gjatë gjithë gjysmës së parë të vitit.

Deri në fund të qershorit të vitit 2013, eksporti i mallrave është rritur me 8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Eksporti i shërbimeve është rritur me 25.6% në tremujorin e parë të këtij viti, pas një rënie 35.7% në të njëjtën periudhë të vitit 2012.

Importi i mallrave është rritur me 2.4%, ndërsa importi i shërbimeve ka rënë me 23.9% në tremujorin e parë të vitit 2013. Rënia vjen nga shërbimet e reduktuara të transportit, udhëtimit dhe të biznesit. Këto

zhvillime sinjalizojnë një përmirësim të llogarisë aktuale e cila pritet të vazhdojë gjatë pjesës tjetër të vitit.

Tabela 9: PVB-ja nominale dhe rritja reale e saj

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012 est.	2013 vlera.
Në milion Euro					
Konsumimi	4,301	4,557	5,023	5,057	5,303
Investime	1,164	1,342	1,531	1,596	1,683
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	657	835	959	939	980
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2,114	2,443	2,737	2,649	2,722
PVB-ja nominale	4,008	4,291	4,776	4,944	5,244
Rritja reale e PVB-së, si %	3.5%	3.2%	4.5%	2.4%	3.7%
IQK, as %	-2.4%	3.5%	7.4%	2.5%	1.7%

Burimi: ASK dhe vlerësimet e njësisë së Makroekonomisë

Metodologjia e përdorur për të kalkuluar rritjen reale është ndryshuar në pajtim me metodologjinë e përdorur nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK). Rritjet për vitet 2008-2011 janë kalkuluar nga ASK-ja, duke treguar rritje reale në krahasim me vlerën nominale të vitit paraprak. Me të njëjtën metodologji është bërë edhe vlerësimi i rritjes reale për vitin 2012 dhe vitet vijuese nga ana e Ministrisë së Financave. Në prill të vitit 2013, BQK-ja ka publikuar të dhënat e rishikuara për eksportet e shërbimeve me vitin 2009 si vit bazë. Të dhënat për vitin 2012 nuk janë të inkuorporuara pasi që ASK-ja pritet të përditësoj llogaritë kombëtare në mënyrë që të pasqyrojë këto ndryshime nga viti 2009.

#### Bilanci i pagesave

Vlerësimet e bilancit të pagesave për tremujorin e parë të vitit 2013 tregojnë një rënie solide të deficitit të llogarisë rrjedhëse prej rreth 20 milionë euro prej asaj që ishte në të njëjtën periudhë të vitit 2012 në 13.4 milion EUR.

Komponenti i të ardhurave sezonale dhe zhvillimet e llogarisë rrjedhëse kanë kontribuar në këtë përmirësim. Llogaritë kapitale dhe financiare shënojnë një bilanc pozitiv edhe pse shumë më të vogël se në vitet e mëparshme. Importi i mallrave ka qëndruar në nivel të ngjashëm me atë të vitit 2012, duke mbajtur një normë konstante të rritjes prej 0.6 për qind deri në fund të gjysmës së parë të vitit aktual. Rënia e çmimit të naftës dhe disa çmimeve të industrisë ushqimore kanë qenë kontribuuesit kryesorë në stabilitetin e importeve. Nga ana tjetër, llogaria e eksportit të mallrave është përmirësuar ndjeshëm duke shënuar një rritje 9.6 për qind.

Tregtia në shërbime ka arritur në 59.500.000 euro në tremujorin e parë të vitit 2013, një përmirësim që rezultoi në zgjerimin e suficit tregtar me një tjetër 25 pikë përqindjeje. Ngritja vjen nga importi i zvogëluar i shërbimeve, në veçanti nga transporti dhe shërbimet e udhëtimit. Kosova ka, në të njëjtën kohë ka rritur eksportet e saj të shërbimeve gjatë kësaj periudhe.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave është përmirësuar gjithashtu me 14.6 për qind në tremujorin e parë të këtij viti. Kjo performancë e përmirësuar është nxitur nga niveli i ulët i flukseve të jashtme të kthimit të investimeve dhe rënies së mbi arkëtimeve të pagesave për stafin ndërkombëtar në Kosovë.

Llogaria e transferimit është rritur pak me 0.3 për qind për shkak të transferimeve të ulura të pasivëve në transferimet e rritura aktivëve për rreth 10 pikë përqindjeje. Remitancat janë rritur me 7.3 për qind duke arritur në 127.800.000 euro në tremujorin e parë të vitit 2013.

Llogaritë kapitale dhe financiare ka mbetur pozitive, megjithëse në një magnitudë gjithnjë e më të vogël se sa në vitet e mëparshme. Ky bilanc qëndroi në 2,2 milionë euro në tremujorin e parë. Investimet e Huaja Direkte (IHD) mbeten kontribuues i madh për ecurinë pozitive. IHD-ja është rritur me 6.9 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2012, duke arritur në 60.900.000 euro. Investimet e portofolit dhe asetëve rezervë ka vazhduar të kontribuojë negativisht për këtë llogari.

### Trendet në papunësi dhe punësim

Sipas të dhënave të regjistrimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale mbi të papunët, numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të muajit prill 2013 ishte 264.316. Kjo paraqet një rënie prej 0,58% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2012. Kategoria e personave të pakualifikuar përbën rreth 57% të të gjithë të papunëve, ndjekur nga femrat (31%) dhe personat me diplomë të shkollës së mesme (28%).

Sipas zyrave të punësimit gjatë periudhës janar-prill 2013, një total prej 7.982 të papunëve ishin të regjistruar. Nga ana tjetër, numri i personave të punësuar përmes zyrave të punësimit ishte 1,465 për katër muajt e parë të vitit 2013.

### Indekset e trendit të inflacionit

Të dhënat e fundit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se niveli i çmimeve është rritur me një mesatare prej 2.7% në gjysmën e parë të vitit 2013 në krahasim me një rritje 1.6% në të njëjtën periudhë të vitit 2012. Çmimet e ushqimeve të cilat kanë një peshë të konsiderueshme në shportë janë rritur me 4%. Çmimet e alkoolit dhe duhanit janë rritur në mënyrë të konsiderueshme, duke shënuar një rritje 8% gjatë kësaj periudhe. Përveç çmimeve të komunikimit (i cili ra me 1%), të gjitha produktet e tjera kanë kontribuar pozitivisht në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve.

Lëvizjet e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare janë reflektuar drejtpërdrejt në çmimin vendor të naftës. Gjatë gjysmës së parë të vitit, çmimet e naftës kanë rënë me një mesatare prej 4.2%. Çmimet e shërbimeve komunale gjithashtu kanë kontribuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve në Kosovë. Çmimet e energjisë elektrike dhe ujit janë rritur me 4.1% duke përjashtuar çmimet e ushqimeve dhe të naftës. Inflacioni bazë është rritur me një mesatare prej 1.1%.

## **2.1.2. Raportimi në lidhje me politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese**

Sa i përket zhvillimeve lidhur me llogaritë e qeverisë, tendenca ka qenë kryesisht në rrugën e duhur në pjesën e parë të vitit. Edhe pse të hyrat kufitare nuk kanë performuar siç ishte planifikuar, të hyrat vendore dhe lokale kanë performuar më mirë se sa ishte planifikuar fillimisht për të kompensuar kështu hendekun e të hyrave kufitare. Përveç kësaj, një-nga të ardhurat në formën e dividendëve do të mundësoj realizimin e plotë të planit vjetor për vitin 2013.

Në gjysmën e parë të vitit, të hyrat nga kufiri janë realizuar në shkallën prej 40% të shumës së planifikuar duke arritur deri në 362,000,000 EUR. Të hyrat vendore janë realizuar në shkallën prej 49% ose 148 milion EURO në terma nominalë. Rritja e tatimit në pronë ka rezultuar me një normë më të lartë të të hyrave komunale të gjeneruara (44% e të hyrave të planifikuara) në shumën prej 27.400.000 Euro. Të ardhurat shtesë planifikohen të gjenerohen nga rritja e shfrytëzimit të nëntokës që deri më tani rezultuar me 9.4 milion Euro të mbledhura. Deri më tani, 30 milionë euro janë mbledhur nga dividendët e pagesave me një tjetër shumë prej 10 milion euro janë planifikuar të mbledhen më vonë gjatë vitit. Liberalizimi i tregut të telefonisë mobile pritet të japin një shtesë prej 20 milion euro të të hyrave gjatë vitit 2013. Si rezultat, të hyrat totale kanë arritur në 1.1 miliard euro që korrespondon me një normë 42.3% të realizimit.

Shpenzimet gjithashtu kanë qenë në përputhje me dinamikën e planifikuar përveç për shpenzimet kapitale. Nga një total prej 621 milion Eurove të buxhetuara për shpenzime kapitale, përafërsisht 30% janë realizuar në pjesën e parë të vitit 2013. Shpenzimet rrjedhëse janë ekzekutuar në normën prej 43.2% (apo 420 Euro formalisht) në gjashtë muajt e parë të vitit 2013. Në përgjithësi, norma e ekzekutimit të shpenzimeve ka arritur në 37.9% të dinamikës së planifikuar për pjesën e parë të vitin. Për më tepër, 2.5 milion Euro janë mbledhur nga pagesa e kredisë së KEK-ut

Bazuar në këto zhvillime dhe projeksione, deficitin buxhetor në fund të vitit pritet të jetë përafërsisht 155 Euro dhe bilanci i përgjithshëm i bankar i qeverisë të arrijë rreth 412 milion Euro

Sa i përket ndryshimeve të politikave fiskale, Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit

Nr. 03/L-048 është ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet Nr. 03/L-221 dhe 04/L-116, i cili përfshinë një rregull detyruese fiskale që e kufizon deficitin buxhetor vjetor në 2% të PBB-së. Tabela më poshtë paraqet shpenzimet e qeverisë qendrore dhe lokale të ndara në nën-kategori.

Tabela 10. Shpenzimet e qeverisë qendrore dhe lokale sipas kategorive

	Buxheti	Gjithsej	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Progresin
000 Euro									%
Pranimet (të hvrat)									
Tatimet kufitare - Dogana	915.198	361.95	44.187	45.872	57.119	71.131	73.13	70.517	40%
Rimbursimet nga Dogana	(2.200)	-1.850	-204	-435	-162	-597	-126	-326	84%
Tatimet vendore - Admin	301.000	147.81	33.547	19.842	19.218	37.762	18.75	18.693	49%
Rimbursimet nga ATK	(32.400)	-	-786	-2.517	-2.447	-4.765	-936	-1.436	40%
Të hvrat tatimore	1.181.59	495.03	76.745	62.761	73.728	103.53	90.82	87.448	42%
Të hvrat jo tatimore - Niveli	44.000	22.119	2.582	2.548	5.576	4.363	3.648	3.403	50%
Të hvrat vetanake	136.000	47.001	8.267	6.815	9.411	8.357	7.952	6.199	35%
Niveli qendror	73.000	19.580	4.517	2.956	4.168	3.341	2.375	2.224	27%
komunat	63.000	27.421	3.750	3.860	5.242	5.016	5.577	3.975	44%
Royalities	22.000	9.431	734	423	451	425	851	6.546	43%
Dividendë	30.000	30.000	0	0	20.000	10.000	0	0	100%
taksa koncesionare	6.300	1.000	500	0	0	500	0	0	16%
Shlverien e kredisë nga	6.000	2.500	500	500	500	500	0	500	42%
Të hvrat nga Privatizimi	26.300	26.300	0	0	0	0	26.30	0	100%
Kredi (disbursimet)	103.060	41.438	175	1.618	167	19.562	19.91	4	40%
Gjithsei Pranimet (Të hvrat)	1.528.95	674.82	89.502	74.666	109.83	147.23	149.4	104.101	44%
Pagesat (Shpenzimet)									
Niveli qendror	1.213.73	470.74	30.351	113.56	80.920	83.513	93.41	68.985	39%
komunat	410.856	143.92	8.189	24.066	24.403	26.856	46.94	13.458	35%
Transaksionet e tjera të	34.162	11.585	344	273	10.508	53	316	92	34%
Gjithsei Pagesat (Shpenzimet)	1.658.75	626.25	38.884	137.90	115.83	110.42	140.6	82.535	38%
Ndryshimi në bilancin		48.573	50.617	-	-5.998	36.817	8.811	21.566	

### Borxhi i përgjithshëm i Qeverisë

Totali i borxhit të qeverisë në fund të muajit korrik 2013 qëndroi në 445 milion euro ose 8.49% e PBV-së duke lënë hapësirë të mjaftueshme për huamarrje. Formalisht, borxhi i jashtëm arriti në 331.000.000 euro deri në fund të muajit korrik 2013, ose rreth 74% e borxhit total të qeverisë. Ju lutem referojuni tabelave 11 dhe 12 për trendet vit pas viti i borxhit të jashtëm dhe borxhit të përgjithshëm qeveritar.

Tabela 11: Borxhi i jashtëm (vlerat në miliona Euro)

	2010	2011	2012	2013
Borxhi i jashtëm	259	254	337	331*
BPV	4,291	4,776	4,944	5,244*
Borxhi i jashtëm si % e BPV-së	6.04%	5.32%	6.82%	6.31%

\*borxhi i jashtëm deri më 31 korrik 2013

\*\*PBB-ja e parashikuar për vitin 2013.

Tabela 12: Borxhi total (vlerat në miliona Euro)\*

	2010	2011	2012	2013
Borxhi total	259	254	411	445**
BPV	4,291	4,776	4,944	5,244***
Borxhi total si % e PBV-së	6.04%	5.32%	8.31%	8.49%

\* Borxhi total është definuar si borxhi i qeverisë qendrore dhe lokale

\*\* borxhi total deri më 31 korrik 2013

\*\*\* BPV-ja e parashikuar për vitin 2013

### 2.1.3. Ndërveprimi i forcave të tregut

#### Madhësia e sektorit privat

Siç shihet në tabelën e mëposhtme, madhësia e sektorit privat si pjesë e BPV-së ka ndryshuar në mes të 85 dhe 90 pikë të përqindjes në periudhën 2009-2013. Investimet private kanë treguar një trend të rritjes gjatë periudhës së njëjtë.



Tabela 13: Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV

	2009	2010	2011	2012	2013
Konsumimi privat	90.0	89.1	88.4	86.2	84.3
Investimet private	19.1	20.7	21.0	21.2	20.8

### Privatizimi

Agjencia Kosovare e Privatizimit gjatë periudhës raportuese ka kryer dy (2) Valë të Privatizimit (Vala 57 dhe 58) dhe një Likuidim të Aseteve të Ndërmarrjeve.

Një total prej 54 kompanive të reja janë përfshirë në dy valët e privatizimit. Janë lidhur 11 spin-of kontrata dhe 44 kontrata të Likuidimit me një vlerë që arrin 10,151,682 Euro respektivisht 5,363,233 Euro. Shuma e të ardhurave nga likuidimet ka arritur në 6,420,845 Euro ndërsa 20 % nga shuma e të ardhurave që ju shpërndahet punëtorëve ha arritur në vlerën 6,437,329€.

Gjatë tre muajve të fundit, autoritetet e likuidimit janë caktuar për 53 NSH të tjera ku procesi i likuidimit ka filluar. Autoritetet e likuidimit kanë rishikuar 11,820 kërkesa dhe kanë lëshuar vendimet për ankuesit.

Në riorganizimin e (kompanive të mëdha) Trepçës, një komision i caktuar nga Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe menaxhmenti i agjencisë, ka përgatitur projekt Termat e Referencave (TR) për kontraktimin e një Ofruesi të jashtëm të Shërbimeve Profesionale dhe i ka prezantuar ato Bordit të AKP-së në qershor të vitit 2013. Në dy muajt vijues, Termat e Referencave janë shpërndarë për komentim dhe shqyrtim nga ana e të gjithë hisedarëve relevant duke e përfshirë këtu edhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Megjithatë, më 13 korrik të vitit 2013, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka njoftuar agjencinë se ka filluar me hartimin e një ligji të ri për Trepçën dhe ka rekomanduar që agjencia të ndalon procedurat e tenderimit derisa të vendoset ligji i ri. Ministria gjithashtu deklaroi se procesi i riorganizimit të Trepçës do të sqarohet nga ligji i ri dhe se termat e referencës për ofruesin e jashtëm të shërbimeve profesionale duhet të pasqyrojnë dispozitat e ligjit të ri.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave të kreditorëve do të ri-shpallet më 1 Nëntor të vitit 2013 në pajtueshmëri me Vendimin numër AC-I-12-0131 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të datës 12.02.2013 dhe në pajtueshmëri me Nenin 17 të Ligjit mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre

### Hyrja dhe dalja e bizneseve

Një numër i përgjithshëm prej 2,463 bizneseve të reja janë regjistruar gjatë periudhës raportuese. Në të njëjtën kohë, 428 biznese i pushuan veprimet e tyre.

### Ambienti biznesor, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative

Në vazhdimësi të përpjekjeve për përmirësimin e ambientit afarist, zbatimi i Regjistrimit Elektronik të Pengut për pasuritë e luajtshme ka filluar gjatë kësaj periudhe raportuese. Regjistrimi, tarifat e shërbimit, hulumtimi, certifikatat digjitale dhe arkivat digjitale mund të qasen në mënyrë elektronike.

### **2.1.4. Sektori Financiar**

Zhvillimet ekonomike në vendet e rajonit kanë shfaqur disa shenja të dobëta edhe në ekonominë e Kosovës. Si pasojë, bankat ndërmorën disa masa parandaluese, përkatësisht reduktimin e bilancit dhe problemeve financiare. Megjithatë, norma e rritjes së kredive dhe depozitave mbetet ndër më të ashprat në rajon. Gjithashtu, sektori i sigurimeve që është ende në proces të konsolidimit, ka raportuar rezultate më të dobëta se sa pritej. Ngecja ishte më e theksuar në institucionet mikrofinanciare, ku ato raportuan përkeqësim në shumicën e treguesve të performancës kryesisht për shkak të mungesës së financimit nga jashtë. Në kundërshtim me këtë, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) ka shënuar një performancë pozitive si në aspektin e asetëve më të larta ashtu edhe në kthimet më të larta në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, sistemi bankar i Kosovës mbeti një kontribuues i shquar i stabilitetit

financiar dhe ekonomik. Që nga qershori i vitit 2013, asetet e sektorit bankar arritën në shumën prej 2,8 miliardë euro, që paraqet një normë vjetore të rritjes prej 5.1 për qind. Norma e rritjes së kredisë është pozitive në 2.8 për qind me kusht që bankat të ishin më të kujdesshme në drejtim të kreditimit të ndërmarrjeve, por gjithashtu me një rritje të ngadaltë të kreditimit të ekonomive familjare (4.4 për qind). Përkundër këtyre masave parandaluese, kreditë për ndërmarrjet dominojnë strukturën e përgjithshme, të pasuara nga kreditë për ekonomitë familjare. Pjesëmarrja e tyre në kreditim total ishte relativisht e ngjashme me vitin e kaluar (2/3 për ndërmarrjet dhe pothuajse 1/3 për ekonomitë familjare). Kreditë për ndërmarrjet tregtare përbëjnë 53 për qind të kredive të gjithëmbarshme për ndërmarrjet. Megjithatë, duhet theksuar se nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme gjatë kësaj periudhe sa i përket kredive sipas aktivitetit ekonomik. Sidoqoftë, është inkurajuese se ka një normë pozitive të rritjes si për sasinë dhe hisen e bujqësisë në totalin e kredive. Ky sektor llogaritet për gati 4 për qind të totalit të kredive, që arrijnë shumën e 48,2 milion euro.

Depozitat mbajtën një normë të rritjes prej 4.4 për qind duke arritur në 2.2 miliard euro. Rritja e depozitave ishte kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të depozitave të ekonomive familjare të cilat mbeten të ashpra. Megjithatë, rritja totale e depozitave ishte relativisht e ngadaltë në krahasim me vitet e mëparshme që u shkaktoan nga një rënie në depozita tek institucionet e tjera financiare. Këtë vit gjithashtu u shënuar një rënie vjetore e depozitave prej 0.1 për qind nga sektori i ndërmarrjeve.

Gjithashtu, në aspektin e depozitave, sektori i ekonomive familjare ishte më dinamik duke shënuar norma të larta të rritjes në krahasim me ndërmarrjet. Ndërmarrjet kryesisht janë përqendruar në përdorimin e fondeve vetanake në vend të linjave kreditore për të mbështetur operacionet e biznesit. Në kundërshtim me këtë, depozitat e ekonomive familjare u ngritën duke treguar tendencën e ekonomive familjare parësisht për të kursyer sesa të konsumojnë. Argumenti për rënie të lehtë të depozitave gjatë kësaj periudhe është se mund të ketë qenë një zhvendosje drejt përdorimit të fondeve të brendshme nga ana e ndërmarrjeve, duke marrë parasysh se kreditimi për këtë sektor ka qenë më i ngadalshëm.

Sistemi bankar vazhdoi të jetë profitabil dhe deri në qershor të vitit 2013 fitimi ishte ndjeshëm më i lartë në krahasim me dy vitet e mëparshme duke arritur shumën 16.2 milion euro.

Si Kthimi Mesatar në Asete (ROAA) ashtu edhe Kthimi Mesatar në Kapital (ROAE) për sistemin bankar kanë qenë pozitivë, por ka pësuar rënie në krahasim me vitin e kaluar. Rritje substanciale është vërejtur në Kthimin Mesatar në Asete (ROAA) dhe Kthimin Mesatar në Kapital (ROAE), përkatësisht 1.2 dhe 11.7.

Bankat komerciale që operojnë në Kosovë në vazhdimësi kanë aplikuar qasje të kujdesshme në menaxhimin e riskut. Në këtë kontekst, bankat janë treguar të kujdesshme dhe konservatore në administrimin e rrezikut të likuiditetit, riskun e kredisë dhe riskun e aftësisë së pagesës. Situata e kënaqshme e likuiditetit është reflektuar nga raporti i kredive me depozita i cili qëndron në 82 për qind, që është pak mbi nivelin e rekomanduar, ndërsa asetet e gjëra likuide në raport me totalin e aseteve likuide ishin 29.7 për qind. Cilësia e portofolit të kredive ka mbetur në një nivel të frenuar pas rritjes relativisht të shpejtë të Kredive Joperformuese (KJP).

Cilësia e portofolit të kredisë e matur nga Kreditë Joperformuese (KJP) në totalin e kredive u frenua në qershor të vitit 2013, mbeti në 7.6 për qind, që në të njëjtën kohë, është niveli më i ulët në rajon. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të kriterëve të ashpërsuara për kreditim të aplikuar nga bankat. Megjithatë, provizionimi i KJP -ve mbetet në 114.3 për qind, duke përfaqësuar një nivel të kënaqshëm. Rrjedhimisht, KJP -të në këtë fazë nuk paraqesin një kërcënim serioz për stabilitetin e sektorit bankar.

Gjithashtu është shprehur qasje e kujdesshme e aplikuar nga sistemi bankar i Kosovës për të ruajtur qëndrueshmërinë e tij përmes nivelit vazhdimisht të lartë të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, i cili e mbajti riskun e insolvencës në nivele të ulëta. Në qershor të vitit 2013, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka vazhduar të përmirësohet duke tejkaluar kërkesat rregullative dhe duke qëndruar në 15.1 për qind.

Përveç kësaj, BQK-ja në baza të rregullta përpilon analiza të testit të stresit për sistemin bankar, i cili fokusohet veçanërisht në riskun e kredisë dhe në riskun e likuiditetit. Rezultatet e fundit të analizave të testit të stresit (të cilat janë botuar rregullisht në Raportet e Stabilitetit Financiar të BQK-së dhe raportet

vjetore) sugjerojnë se sistemi bankar i Kosovës është i aftë të përballojë nivele më të larta të kredive jo performuese se sa nivelet aktuale. Gjithashtu, rezultatet mbi riskun e likuiditetit janë pozitive duke sugjeruar se bankat që operojnë në Kosovë kanë likuiditet të mjaftueshëm për të shërbyer normat më të larta të tërheqjeve të depozitave në një periudhë relativisht të shkurtër kohore.

Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike (DSFAE), përveç detyrave standarde, ka iniciuar përpilimin e indeksit të çmimeve të pronës së patundshme (çmimet e listuara). Përveç kësaj, në shkurt të vitit 2013, DSFAE-ja në bashkëpunim me Fondin Evropian për Evropën Juglindore FEEJ-në është në një proces për të marrë përsipër projektin e analizimit të mbi-borxhit të ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve që është planifikuar të përpilohet në baza të rregullta.

## **2.2. Kapaciteti për t'u përballuar me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut**

### **2.2.1. Kapitali njerëzor dhe fizik**

#### Kapitali njerëzor

Sa i përket trendit të zhvillimit të kapitalit njerëzor në fushën e arsimit, numri i përgjithshëm i studentëve në universitetet publike dhe tre kolegje private është rreth 100,000 gjatë vitit akademik 2012-2013. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin parauniversitar është 418,352. Numri i nxënësve në nivelin e mesëm të lartë u përqendrua në 104,268; në nivelin e mesëm të ulët në 288,378 për vitin akademik 2012/2013. Ndërsa 4732 të tjerë janë në sistemin e arsimit privat. Proporcioni student për mësues për nivelin e mesëm të lartë është 19.2, ndërsa proporcioni i nxënësve për klasë sillet rreth 31 studentë.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka kryer një verifikim të 15 standardeve profesionale në sektorët në vijim: makineri, ekonomi, tregti, turizëm dhe emergjencë. AKK-ja i ka vërtetuar dhe regjistruar 6 (gjashtë) kualifikime të niveleve III dhe IV në KKK-ë siç janë: Asistente Administrative, Saldues, Elektricitist, Instalues i Ngrohjes Qendrore, Murator, Instalues Kanalizimi dhe Teknologji Informative.

AKK-ja ka akredituar Institucionet e Arsimit Profesional (IAP) për të ofruar kualifikime të regjistruara në kornizën e kualifikimeve brenda afatit prej një deri në tre vjet, me ose pa kushte.

Financimi publik për hulumtim dhe inovacione për këtë vit akademik arrin shumën prej 580 000 euro. Kjo shumë u dedikohet programeve në vijim:

- Mobiliteti kërkimor 100,000 euro;
- Projekte të vogla shkencore 150,000 euro;
- Bursat të doktoraturës në universitetet më të mira të botës 100,000 euro;
- Burimet e bibliotekës elektronike 60,000 euro;
- Për publikime dhe shtypje 100,000 euro;
- Konferencë shkencore dhe evenimentet tjera përkitazi me shkencën 45,000 euro.

Sipas të dhënave të Qendrave të Arsimit Profesional - 2456 kandidatë janë përfshirë në trajnime gjatë periudhës raportuese. Prej tyre, 1,004 janë femra, 118 janë nga jo-shumica, dhe 28 janë njerëz me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, qendrat i kanë certifikuar 1695 kandidatë. Kandidatët tjerë 1,040 sosh kanë ndjekur trajnimet përmes projektit Kosvet VI.

Disa shërbime trajnimi që nuk janë në dispozicion në qendrat e trajnimit janë blerë përmes marrëveshjeve me shoqatat Handikos, Kosova Handicap, dhe Sindromën Doun, ku kanë ndjekur trajnimet rreth 300 persona me aftësi të kufizuara.

#### Kapitali fizik

Si investimet publike ashtu edhe ato private kanë treguar një trend rritës nga viti 2009 e tutje. Investimet private mbizotërohen nga ndërtimet, ndërsa, një pjesë e konsiderueshme e investimeve publike është e dedikuar për ndërtimin e autostradave.

Tabela 14: Investimet Publike dhe Private, 2009-2013

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
Investimi Privat	766	887	1,003	1,046	1,093
Investimi Publik	400	455	528	550	590

**Shënim:** Të dhënat për vitin 2012 janë një vlerësim për investime private, për vitin 2013 parashihet një normë e ekzekutimit prej 95% për shpenzimet kapitale publike

Ka pasur një rënie rapide të IHD-ve në vitin 2012 e pasuar me një ngritje të madhe në vitin 2013 (shikoni tabelën më poshtë për shifrat). IHD -të janë të orientuara kryesisht në pronë të patundshme (pjesërisht të përbërë nga remitencat e investuara në blerjen e pronave), transport, telekomunikacion dhe ndërtimtari. Këta sektorë përbëjnë së bashku rreth 69% të investimeve të huaja.

Tabela 15: Investimet e Huaja Direkte (IHD) si % e GDP-së dhe rezervës së tij nga viti 2009

Përshkrimi	2009	2010	2011	2012	2013
IHD si % e PBB-së	7.0	7.7	7.9	4.4	10.0
rvat të IHD-së, në euro miliona	1,493	1,824	2,203	2,419	2,946

Sa i përket **infrastrukturës rrugore**, progresi i punës në autostradën M9 është si vijon: realizimi në segmentin 7 është 30%, në segment 8 është 70%, dhe në segmentin 9 është 71%. Që të tre segmentet janë planifikuar të përfundojë deri në fund të vitit 2013. Progresi i punës në segmentin M9 Sllatinë - Gjurgjicë është 98% e punës e përfunduar. Segmenti M2, Shkabaj - Milloshevë ka përfunduar në normën prej 95%. Sa i përket infrastrukturës rajonale rrugore, janë përfunduar në total gjashtë projekte me 18.7 kilometra rrugë të riparuar.

## 2.2.2. Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

### Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit

Sa i përket zhvillimeve në sektorin e telekomunikacionit, legjislacioni dytësor është duke u zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit mbi komunikimet elektronike. Për këtë qëllim, kohëve të fundit janë miratuar dy rregullore:

- Rregullorja teknike për rregullimin e telekomunikimeve elektronike, të miratuar në korrik të vitit 2013(Ref. Nr. Prot.025/B/13);
- Rregullorja mbi pagesat për mbikëqyrjen e tregut, e miratuar në korrik të vitit 2013 (Ref. Nr.Prot.021/B/13).

Në muajin korrik qeveria ka marrë një vendim nr 04/88 për liberalizimin e mëtejshëm të shërbimeve të telekomunikimeve/telefonisë mobile. Kjo u mundëson operatorëve që të ofrojnë shërbimet të telefonisë mobile të brezit të ardhshëm duke përdorur burimet e frekuencave në dispozicion

Sa i përket treguesve kryesorë të tregut të telekomunikacioneve, norma e penetrimit e telefonisë fikse qëndron në 4.8% për banorët. Të dhënat e fundit nga tremujori i parë i vitit 2013 tregojnë një rënie të lehtë prej 0.49% në numrin e përdoruesve të telefonit mobil. Depërtimi i telefonisë mobile qëndron në 95.16% në fund të tremujorit të parë të vitit 2013. Numri i linjave me qasje në broadband internet të raportuara nga operatorët ka arritur në 147.533, një rritje prej 2.53% krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Sipas të dhënave të fundit zyrtare të raportuara nga operatorët, shkalla e penetrimit për familjet me qasje në broadband internet është 58%, ndërsa depërtimi i Internetit për 100 banorë qëndron në 8.49% në fund të tremujorit të parë të vitit 2013. Në Kosovë janë 55 ofrues të shërbimeve të internetit. Sektori i shërbimeve mobile në Kosovë përbën rreth 78% të vlerës totale të sektorit të komunikimeve elektronike.

### Struktura Sektoriale

NVM-të përbëjnë rreth 99% të të gjitha ndërmarrjeve. Nuk ka ndryshime në klasifikimin e NVM-ve sipas madhësisë apo sipas numrit të njerëzve që ato punësojnë nga raportimi i fundit. Sa i përket NVM-ve për nga struktura e pronësisë, ju lutem shikoni tabelën 14 në vijim.

Tabela 16: NVM-të sipas pronësisë:

Lloji i pronësisë	
Biznesi individual	88.22 %
Partneriteti i përgjithshëm	2.79 %
Partneriteti i kufizuar	0.07 %
Kompania me Përgjegjësi të Kufizuar (LLC)	7.98 %
Kompani aksionare	0.32 %
Kompanitë në pronësi të huaj	0.50 %
Në pronësi shoqërore	0.02 %
Në pronësi publike	0.01 %
Kooperativat bujqësore	0.06 %
Të tjera (nën juridiksionin e AKM-së)	0.03 %

### 2.2.3. Ndikimi i shtetit në konkurrencë/konkurrueshmëri

#### Ndërmarrje të mëdha në pronësi të shtetit

Shkëputja e Kompanisë së Distribucionit dhe Furnizimit me Energji (KEDS) nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është finalizuar në maj të vitit 2013. Me këtë, pronësia është transferuar tek kompania aksionare Çalik Limak Energy e Kosovës dhe privatizimi i operatorit të distribucionit dhe furnizimit ka përfunduar. Të gjitha kushtet për mbylljen e këtij transaksioni janë plotësuar, duke përfshirë miratimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për transferimin e licencës, kontrollin e kompanisë dhe pagesës prej 26.300.000 në buxhetin e Kosovës.

Dispozitat e marrëveshjes së transaksionit kanë siguruar një investim prej 300 milion euro për 15 vitet e ardhshme, garancën për pagesën e gjeneratorëve të KEK-ut për sasinë e energjisë së furnizuar, dhe garantimin e kontratave punës për tri vite për 2720 punonjësit aktualë.

Sa i përket privatizimin e kompanisë së Postës dhe Telekomit (PTK-së), në prill të vitit 2013 u pranuan ofertat teknike dhe financiare të dy ofertuesve M 1 International dhe konzorciumi Axos Capital GmbH dhe Najafi Companies në partneritet me British Telecom-in. Operatori më i favorshëm nga pretenduesit iu dha konzorciumit Axos Capital GmbH dhe Najafi Companies në partneritet me British Telecom-in. Sipas dosjes së tenderit, kompania fituese ka pasur një afat kohor deri më 22 korrik të vitit 2013 për të nënshkruar marrëveshjen e blerjes. Me kërkesën e konzorciumit, afati është zgjatuar deri jo më vonë se 30 shtatori i vitit 2013.

#### Ndihma shtetërore

Gjatë vitit 2013, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht për projekte kapitale dhe mbulimin e kostos së energjisë, blerjes së naftës së papërpunuar për ngrohje, tarifë të trenave dhe shërbimet e furnizimit me ujë. Shuma e ndihmës së dhënë në vitin 2013 është 29 milion euro.

Sektorët që kanë marrë ndihmën shtetërore në formën e subvencioneve dhe granteve për projekte kapitale në mes të shkurtit dhe gushtit të vitit 2013 janë:

- Sektori i energjisë, një shumë prej 16,138,861.72 euro;
- Sektori i hekurudhave, një shumë prej 16,138,861.72 euro;
- Sektori i nxehtësisë, një shumë prej 473,540.66 euro;
- Sektori i Ujit dhe Mbeturinave, një shumë prej 1,679,496.58 euro.

Aktualisht është duke u themeluar zyra e ndihmës shtetërore e cila do të jetë autoritet monitorues brenda Autoritetit të pavarur të Konkurrencës. Pra, Marrëveshjet e kontrollit dhe monitorimit të nënshkruara në mes të NP-ve dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik janë duke u përdorur si mekanizma monitorues përkitazi me ndihmat shtetërore të dedikuara për ndërmarrjet publike. Këto marrëveshje rregullojnë mënyrën e përdorimit të ndihmës shtetërore, kërkesat për raportim tremujor dhe metodën e auditimit të fondeve të tilla.

### 2.2.4. Integrimi i tregtisë

Bashkimi Evropian është partneri më i madh tregtar i Kosovës. Importet nga BE-ja janë rritur për 8.4%,

duke arritur shumën prej 486.000.000 euro në gjysmën e parë të vitit 2013. Ato përfaqësojnë pjesën më të madhe me rreth 41% të totalit të importeve. Vendet kryesore importuese janë Gjermania (24.6%), Italia (22%), Greqia (15.5%) dhe Sllovenia (6%).

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së gjithashtu kanë shënuar rritje për 4%, duke arritur shumën prej 58.400.000 euro ose 39.3% të totalit të eksporteve. Gjermania dhe Italia janë partnerët më të mëdhenj për eksportet e Kosovës me rreth 79.5% të eksporteve drejtë BE-së. Vetëm eksportet në Itali arrijnë 40 milion euro ose 69.5% të eksporteve në vendet e BE-së.

Struktura e eksporteve është e dominuar nga, nikeli, mbeturinat dhe hekurishtet e bakrit, lëkurat e papërpunuara të gjedhëve, turbinat me avull të ujit dhe turbinat e tjera me avull, dhe koncentrat i zinkut. Ndërsa mallrat kryesore të importuara përfshijnë vajra nafte dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, automjetet, duhani, dhe medikamentet.

Importi dhe eksporti i shërbimeve ka arritur në 105.3 milion euro, përkatësisht në 45.75 milion euro deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2013.

## 3. STANDARDET EVROPIANE

### 3.1. TREGU I BRENDSHËM

#### 3.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vazhduar më tej me riorganizimin e njësive të saj. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare tani është plotësisht funksionale sipas strukturës së re. Divizioni i Cilësisë së Infrastrukturës është themeluar si një njësi e veçantë në kuadër të Departamentit të Industrisë në korrik të vitit 2013, dhe është emëruar Shefi i Divizionit.

Këshilli Ndër Ministror për Politika Tregtare është zëvendësuar nga Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik. Në qershor të vitit 2013, Grupi Punues për Politika Tregtare në shërbime ka zhvilluar takimin e katërt mbi ofrimin e informacionit në shërbime për bizneset lokale.

Të dhënat mbi barrierat tarifore dhe pyetësorët të mbledhura nga nëngrupet e Politikave Tregtare janë transferuar në Bazën e të Dhënave për Qasje në Treg (BDHQT), e cila është krijuar dhe funksionon sipas udhëzimit të sekretariatit të CEFTA-së. Në këtë bazë të të dhënave në total janë regjistruar 17 raste. Për më tepër, në korrik të vitit 2013, stafi i MTI-së përgjegjës për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave është trajnuar përkitazi me BDHQT-të.

Autoritetet e Kosovës kanë marrë pjesë në disa takime përkitazi me aktivitetet e CEFTA-së, siç janë: takimi i shtatë i Nën-komitetit mbi Tarifatat dhe jo-tarifatat në Shkup, takimi i shtatë i Grupit Punues mbi Barrierat Teknike në Tregti (BTT) në Beograd, takimi tetë i grupit punues për shërbime në Sarajevë, dhe së fundi, mbledhja e ekspertëve dhe zëvendësministrave në Sarajevë.

Sa i përket prioritetëve tregtare të Kosovës, nga shkurt e tutje, MTI-ja ka negociuar me Turqinë mbi produktet industriale dhe bujqësore. Më hollësisht, procesi i negociatave mbi produktet industriale është bërë në tri faza. Fillimisht, produktet të cilat janë importuara në Kosovë nga Turqia në 8-shifra të nivelit të Sistemit të Harmonizuar (SH); në fazën e dytë, lista e produkteve të liberalizuar plotësisht sipas kërkesës së Turqisë; dhe faza e tretë mbulon pjesën tjetër të produkteve të mbetur nga fazat e mëparshme dhe produkte të tjera industriale. Gjithashtu, në negociatat për produktet bujqësore, Turqia fillimisht ka përgatitur listën e produkteve bujqësore për t'u negociuar; Autoritetet kosovare kanë ofruar komentet dhe propozimet e tyre përkitazi me listën e propozuar; dhe në fund, është negociuar me Turqinë lista e prodhimeve bujqësore e formuluar nga Kosova.

Në kuadër të përgatitjeve për aspektet që kanë të bëjnë me tregtinë të negociatave të MSA-së, në gusht të vitit 2013, MTI-ja ka përgatitur listën e produkteve të ndjeshme industriale dhe bujqësore me 2, 4 dhe 8 shifra të Sistemit të Harmonizuar.

#### Standardizimi

Gjatë periudhës së raportimit, u miratuan gjithsej 560 standarde. Këto standarde janë të ndarë në sektorët vijues: 380 standarde elektrike, 110 standarde për pajisje personale mbrojtëse dhe 70 standarde për teknologji informative.

Takimi promovues "Standardet e Jetesës" është mbajtur në OEK-ë. Takimi u zhvillua më 1 gusht të vitit 2013, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bizneseve për zbatimin e këtyre standardeve.

#### Akreditim dhe Vlerësimi i Konformitetit

Korniza ligjore mbi vlerësimin e konformitetit është plotësuar më tutje me qasje të re legislative, si në vijim:

- Rregullorja teknike Nr. 04/2013 mbi Sigurinë e Makinerisë;
- Rregullorja teknike Nr. 05/2013 mbi Sigurinë e Lodrave, dhe;
- Rregullorja teknike Nr. 06/2013 mbi Shenjën e Konformitetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës (DPAK) gjatë periudhës raportuese ka marrë dy aplikacionet në vijim për akreditim të organeve inspektuese: për të kontrolluar ashensorët dhe komponentët e tyre të sigurisë; entitetin dhe një laborator mbi vreshtarinë dhe laboratorët e enologjisë.

Zona e vlerësimit të konformitetit përfshin disa aktivitete të kryera në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DPAK), si në vijim: është realizuar një vlerësim në bazë të analizave laboratorike të lëndës djegëse të lëngshme, tri në bazë të vëzhgimit të rregullt vjetor të laboratorëve që mbulon analizën e ujit për pije dhe ujërave rekreative, kontrollin e cilësisë së ushqimit, laboratorin mikrobiologjik të ushqimit dhe ujit, dhe tri anketimet e kryera pas gjashtë muajsh të Trupave Vlerësues të Konformitetit (TVK). Gjithashtu, akreditimi i laboratorëve është kryer mbi analizën e materialeve të ndërtimit, lëndës djegëse të lëngshme dhe së fundi, është kryer një vlerësim mbi organet inspektuese për lëndët djegëse të lëngshme.

### Metrologjia

Etaloni për masë dhe pesha të masës është kalibruar me etalonin (klasa E2) gjatë muajit maj të vitit 2013. Gjithashtu, Agjencia i Metrologjisë së Kosovës (AMK) e ka nënshkruar kontratën me kompaninë për blerjen e furgonit të etalonit i cili do të përdoret për verifikimin e matjes së shitjeve të pikave të karburantit.

Përkritazi me ngritjen e kapaciteteve në maj të vitit 2013, 7 zyrtarë të Agjencisë së Metrologjisë janë trajnuar dhe certifikuar nga TUBITAK-UME në Turqi në fushën e masës, vëllimit, rrjedhës, forcës, dhe presionit.

### Mbikëqyrja e tregut

Inspektorati i Tregut gjatë ushtrimit të rolit të tij mbikëqyrës, për zbatimin e legjislacionit mbi sigurinë e konsumatorit dhe produktit të tregtisë së brendshme, ka kryer mbi 370 inspektime gjatë periudhës raportuese. Inspektimet kanë rezultuar me ndërmarrjen e këtyre masave:

- 7 gjoba administrative të lëshuara për shkelje të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit;
- 5 raste të iniciuara në gjykatat përkatëse për shkelje të legjislacionit të sigurisë së produktit të përgjithshëm;
- 18 raste të iniciuara në gjykatat përkatëse për shkeljen e legjislacionit mbi tregtinë me naftë;
- 10 raste të iniciuara në gjykatat përkatëse për shitjen e naftës pa licencë;
- 3 raste të iniciuara për masa administrative për mos-përmbushje me legjislacionin e Inspektoratit të Tregut në prezantimin e dokumentacionit ligjorë; 20 ankesa të shqyrtuara për shkelje të legjislacionit mbi mbrojtjen e konsumatorit;
- 307 produkte (lodra, veshje sportive, produkte ushqimore) janë konfiskuar;
- 25.000 etiketa janë konfiskuar sepse janë tregtuar pa dokumentacionin e duhur.

### Mbrojtja e konsumatorit

Për të zhvilluar më tej një treg të sigurt dhe të duhur financiar, një Memorandum i Mirëkuptimit (MM) për mbrojtjen e konsumatorëve u nënshkrua më 18.07.2013, në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit ka mbajtur tri mbledhje gjatë periudhës raportuese ku ka ekzaminuar ankesat e konsumatorëve që paraqiten nga faturat e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) tani Distribuimi dhe Furnizimi me Energji i Kosovës (KEDS). Megjithatë, është duke u përgatitur një rekomandim përfundimtar për KEDS-in nga Këshilli i bazuar në ankesat e pranuar.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit ka pranuar gjithsej 90 ankesa. Nga këto, 44 janë shqyrtuar dhe 46 janë në proces për t'u shqyrtuar. Shumica e ankesave të pranuar, erdhën nga Inspektorati i Tregut në kuadër të MTI-së dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

Sa i përket fushatave ndërgjegjësuese, janë kryer disa aktivitete duke përfshirë edhe ligjërata për studentë të shkollave të mesme dhe komunitetin RAE, shpërndarjen e fletëpalosjeve në shkolla, universitete dhe gazeta, me ç'rast janë shpërndarë 16.000 fletëpalosje.

### **3.1.2. Lëvizja e lirë e kapitalit**

Ligji mbi Sistemin e Pagesave Nr 04/L-155 është miratuar nga Kuvendi në maj të vitit 2013. Është hartuar legjislacioni sekondar për implementimin e ligjit mbi sistemin e pagesave. Janë hartuar rregulloret në



vijim:

- Rregullorja mbi kliringun dhe funksionimin e llogarive të kliringut;
- Rregullorja mbi Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar.

### 3.1.3. Doganat dhe Tatimet

#### a. Doganat

Gjatë kësaj periudhe të raportimit janë kompletuar resurset e nevojshme njerëzore, teknike dhe të infrastrukturës fizike në pikat e kalimit kufitar (PKK) të Merdarës, Mutivodës, Bërnjaut dhe Dheut të Bardhë//Mucibabës me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të doganave dhe për zbatimin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK). Sistemi elektronik ASYCUDA është operacional në të gjitha PKK-të. Përveç kësaj, ka filluar zbatimin e zhdoganimit të mallit në Jarinjë dhe Bërnjak dhe është në përputhje me protokollin dhe planin e veprimit të procedurave doganore në këto dy PKK. Gjatë periudhës raportuese janë zhdoganuar 7532 ngarkesa në PKK-në Jarinjë, ndërsa në PKK-në Bërnjak u zhdoganuan 2413 ngarkesa. Pas ndërtimit të garazhit për ekzaminim të hollësishëm në PKK-në Vërmicë, është ndërtuar objekti i linjës së dytë të kontrollit dhe është instaluar kontrolli me rreze X i valixheve.

Sa i përket masave kundër ekonomisë joformale, janë kryer 23 aktivitete në bashkëpunim me agjencitë tjera institucionale mes muajit maj dhe gusht. Numri i përgjithshëm i operacioneve të organizuara të dyshimeve për kontrabandë dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme në mbarë vendin është 135. Numri i rasteve të zbuluara vetëm në rajonin e Mitrovicës duke përfshirë kontrabandimin e mallit është 69 (pije jo-alkoolike, lëng frutash, derivate, produkte ushqimore dhe produkte higjienike).

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve, në periudhën maj-gusht gjithsej 116 zyrtarë të doganave kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnuese. Temat e trajnimit mbulojnë fushat në vijim: Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI), Menaxhimi i Dokumenteve Zyrtare, Shkolla për Integrimin Evropian, Zbulimi Ndërkombëtarë i Aseteve dhe Kthimin e tyre, Hetimi i kontrabandës, Moduli Tarifor II, Statistikat e Mallrave, Parandalimi i Kontrabandës me Cigare, Etika dhe Anti-Korrupsioni, Sjellja Organizative, Terrorizmi dhe Vetëdijesimi, Çështjet e Protokollit shtetërorë; Seminar mbi Mallrat e Akcizës, Përhapja e Shpejtë, Trajnimi për Trajnerë, Përmirësimi i Cilësisë së Hetimeve Financiare, Seminar mbi Kimistët e Doganave Evropiane.

#### b. Tatimet

Sa i përket masave dhe procedurave për mbledhjen e tatimit, në mes muajve maj dhe gusht janë lëshuar gjithsej 740 numra fiskalë dhe janë instaluar 865 arka fiskale elektronike. Gjithsej janë lëshuar 18.085 numra fiskal, ndërsa janë instaluar gjithsej 23.176 arka fiskale elektronike.

Gjatë periudhës raportuese aplikacioni i ri për menaxhimin e rasteve të mbledhjes së detyrueshme (SMRM) është bërë plotësisht operacional. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e një sistemi më efektiv të mbledhjes. Si rezultat, janë lëshuar 35 njoftime automatike nga aplikacioni për tatimpaguesit. Për më tepër, është themeluar një Task Forcë që të merret kryesisht me zbatimin e procedurave për mbledhjen e borxheve nga NSH-të. Njësia e mbledhjes së detyrueshme ka kryer 18,189 euro aktivitete të vizitave dhe 34 kontrolle të rastit që rezultojnë në një qarkullim prej 14,782,610 euro dhe përkatësisht 873,266 euro.

Në luftën kundër shmangies tatimore, organet tatimore kanë ndërmarrë një sërë aktivitete. Janë zbuluar nëntë raste të shmangies tatimore që arrin shumën prej 1,422,401 euro. Janë kryer 21,836 vizita tjera për të parandaluar dështimin në përmbushjen e detyrimeve tatimore duke sjell kështu një qarkullim shtesë 21.5 milion euro. Gjithashtu janë lëshuar 3,360 gjoba detyruese në shumën prej rreth 1 milion euro. Janë kryer gjithsej 104 inspektime për mospërmbushje si rezultat i informacionit të përdorur nga analiza e riskut. Rezultati monetarë i këtyre inspektimeve ishte 12,7 milion euro tatim shtesë. Në të njëjtën kohë janë lëshuar 395 gjoba detyruese në shumën prej 63,125 euro. Qendra e Thirrjeve ka kryer 4,064 thirrje që ka rezultuar në një qarkullim prej 379,951 Euro.

Përmes shërbimeve online në periudhën në mes muajit maj dhe gusht janë kryer aktivitetet në vijim:

- janë shkarkuar gjithsej 189,701 deklarata tatimore në format elektronik;
- janë regjistruar gjithsej 2,552 biznese individuale, 23 ortakëri, 594 kompani me përgjegjësi të kufizuar dhe 3 korporatat përmes Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve dhe pikave të shërbimit One-Stop-

- Shop në të gjitha qendrat komunale;
- janë lëshuar gjithsej 4,012 vërtetime tatimore për personat fizikë;
- gjithsej 252,093 deklarime elektronike;
- gjithsej 28,027 tatimpagues të regjistruar në sistemin e dosjeve elektronike.

Administrata Tatimore gjatë kësaj periudhe ka kryer gjithsej 42 sesione trajnuese me një numër të përgjithshëm prej 378 pjesëmarrësve. Trajnimet ishin në fusha të ndryshme, siç janë: Menaxhimi dhe përdorimin i SIGTAS-it, teknikat e procedurave dhe kontrollit, traktatet ndërkombëtare tatimore, mbledhja e detyrueshme, roli i auditorëve përkitazi me korrupsionin dhe mashtrimin si dhe legjislacionin tatimor.

### **3.1.4. Konkurrenca**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë kësaj periudhe raportuese ka marrë këto vendime: rastin SharrCem, duke liruar kompaninë nga vendosja e sanksioneve administrative në mungesë të fakteve relevante dhe vendimi për dhënien e pëlqimit për 'Llactalis Group' për realizimin e bashkimit.

### **3.1.5. Prokurimi Publik**

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) kryen monitorimin e rregullt të rasteve në përpjekje për të rritur transparencën. Që nga maji i vitit 2013, janë kryer 9 monitorime në lidhje me zbatimin e dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik. Janë bërë 123 njoftime mbi procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës. Menaxhimi i kontratës publike është kryer përmes monitorimit në 7 autoritete kontraktuese përkatëse. Sa i përket numrit të interpretimeve, janë pranuar 30 interpretime në formë të shkruar, 330 përmes thirrjeve telefonike dhe 250 përmes postës elektronike.

Në anën tjetër, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) prej 1 maji deri më 16 gusht ka pranuar gjithsej 181 ankesa nga operatorët ekonomik. Nga këto, 116 ankesa janë shqyrtuar nga OSHP-ja, ndërsa 65 tjera janë në proces të shqyrtimit. Nga ankesat e shqyrtuara, 27% kanë shkuar në favor të operatorëve ekonomikë, 37% në favor të autoriteteve kontraktuese, ndërsa 35% janë afër finalizimit. Për periudhën raportuese, për shkak të mospërmbushjes së rregullave të panelit shqyrtues, OSHP-ja gjobiti tri autoritete kontraktuese, dhe mori vendimin për të marrë certifikatën e profesionalizmit nga një zyrtar i prokurimit publik.

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, KRPP-ja në muajin maj ka kryer trajnime të prokurimit publik për fillestar. Trajnimi u ndoq nga 78 pjesëmarrës, nga të cilët 68 u pajisën me certifikata për prokurimin bazik publik. Trajnimit i avancuar i prokurimit, që zgjati një muaj, u zhvillua në muajt maj/qershor dhe në të morën pjesë 450 zyrtarë. KRPP-ja në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit ITC-ILO dhe Komisionin Evropian ka organizuar një trajnim për të certifikuar trajnerët e rinj për prokurim publik, i njohur si "Programi i Trajnimit të Trajnerëve për Menaxhimin e Prokurimit". Nga ky trajnim kanë përfituar gjithsej 26 zyrtarë.

### **3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit**

Në kornizën ligjore në fushën e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI), Ligji nr 04/1-187 mbi Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Originës është miratuar në muajin maj dhe ka hyrë në fuqi më 19 korrik të vitit 2013. Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e fitimit dhe mbrojtjen e emërtimeve të originës dhe treguesve gjeografikë të produkteve. Ligji është i zbatueshëm për të gjitha produktet për të cilat mbrojtja e emërtimeve të originës vjen nga një rajon, vend specifik ose shtet. Për plotësimin e legjislacionin në këtë fushë, u miratua Udhëzimi Administrativ (UA) nr 08/2013 mbi Përfaqësuesit e Autorizuar në fushën e Pronës Industriale më 18.06. 2013.

Rregullorja mbi Ndërmjetësimin e Mosmarrëveshjeve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave Përkatëse nr. 5/2013 u miratua më 30 janar të vitit 2013. Që nga shkurti, kjo rregullore është duke u zbatuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), kur filluan procedurat për rekrutimin e ndërmjetësuesve. Shtatë ndërmjetësues ishin përzgjedhur, dhe ata u trajnuan nga ndërmjetësi i vetëm nga rajoni i licencuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI). Si rezultat, ndërmjetësit u emëruan nga Qeveria e Kosovës më 04 Maj të vitit 2013,.

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimit

(MM) më 25 maj të vitit 2013 me Policinë e Kosovës në mënyrë që të vendosë mjetet juridike për të parandaluar veprimtarinë e piraterisë, të mbrojë veprat origjinale dhe për të ndëshkuar autorët e krimit. Ky bashkëpunim i rritur ka rezultuar në një luftë më të efektshme kundër piraterisë, në veçanti përmes Task Forcës kundër piraterisë.

Në qershor të vitit 2013, Task Forca ka miratuar Rregullat e saja të Brendshme të Procedurës dhe Planin e Veprimit. Ajo gjithashtu mori një vendim për të ndërmarrë masa përkitazi me shkeljen e të drejtave të autorit. Afati i caktuar më 15 gusht u bë publik duke deklaruar se të gjithë personat dhe entitetet e përfshira në prodhim, shitje dhe shpërndarjen e produkteve që përmbajnë materiale të mbrojtura të të drejtave të autorit, duhet të heqin këto produkte nga tregu dhe nga faqet e internetit. Më 16 gusht të vitit 2013, janë ndërmarrë masa konkrete të inspektimit të tregut në disa qytete. Përafërsisht 10 mijë CD që përmbajnë muzikë, filma, video lojra dhe programe kompjuterike u sekuestruan brenda një jave. Inspektorati i tregut ka inicuar procedurat e kundërvajtjes pas të cilave rastet janë proceduar në gjykatat kompetente. Në të njëjtën kohë, Task Forca, veçanërisht Njësia për hetimin e krimeve kibernetike në kuadër të policisë së Kosovës, ka ndërmarrë veprime kundër faqeve të internetit që përmbajnë materiale të piratuara, kryesisht për muzikë, filma dhe video lojra.

Sistemi i Automatizuar i Pronësisë Industriale (IPAS), është bazë e të dhënave ku regjistrohen të gjitha objektet e pronësisë industriale, kjo bazë e të dhënave tashmë është plotësisht funksional. Nga muaji maj deri në shtator të vitit 2013, numri i objekteve të regjistruara është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 17: Regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale (Maj-Shtator 2013)

Markat tregtare		Patentë	
Vendimet	1998	Vendimet (përfshirë refuzimet)	188
Certifikatat	1375	Njoftimet e lëshuara për pagesën e gjobave përkitazi me vendimet	44
Njoftimet	201	Vendimet tjera	30
Njoftimet e lëshuara për pagesën e gjobave përkitazi	2504		
Publikimet përmes SAPI	1937		

Që nga maji i vitit 2013, janë botuar 6 buletine nga Zyra e Pronësisë Industriale (ZPI) (çështjet 19-25). Numri i gjithëmbarsëm i aplikimeve të publikuara është 4175.

Sa i përket aktiviteteve të zbatimit, Doganat e Kosovës kanë kryer veprime në 64 raste nën dyshimin e mallrave të falsifikuara. Nga këto, 24 raste kanë rezultuar në 233.881 copë mallra të falsifikuara me vlerë prej 293,361 euro. Gjithashtu, u krijuan 30 profile të reja të riskut përkitazi me mallrat që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. U identifikuar gjithsej tri raste sipas detyrës zyrtare me vlerë prej 1.221,00 euro dhe një sasi prej 135 copë.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve në fushën e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI), në gusht të vitit 2013, Zyra e Pronësisë Industriale i rekrutoi dy zyrtarë, Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Pronë Industriale dhe një Zyrtar të Lartë për çështjet administrative .

Konferenca me temën " Pirateria dhe shkeljet e tjera të së Drejtës së Autorit ", u organizua nga Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta më 30 korrik, 2013. Konferenca informoi pjesëmarrësit rreth institucioneve përkatëse dhe masat e ndërmarra për të luftuar piraterinë. Konferenca u ndoq nga mbajtësit e të drejtave nga Kosova dhe jashtë vendit.

### 3.1.7. Punësimi dhe politikat sociale

Sa i përket zhvillimeve legislative në sektorin e punës, Ligji nr.04/L-161 mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është amenduar dhe miratuar nga Kuvendi më 16 maj të vitit 2013; Ligjin mbi Dhënien e Lejeve të Punës dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj Nr 03/L-136 është anuluar.

Disa prej dispozitave të tij janë inkorporuar në Ligjin e miratuar së fundmi për të Huajt, nr 04-L-219 (miratuar në korrik të vitit 2013).

Udhëzimi Administrativ nr. 03/2013 mbi Procedurat e Regjistrimit, Certifikimit, dhe Punësimit për të papunët për të aplikuar për skemën e asistencës sociale u miratua më 26.04.2013. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të rregullojë bashkëpunimin në mes të Qendrës për Punë Sociale dhe Zyrave Komunale të Punësimit, procedurat për të papunët që të aplikojnë për kategorinë e dytë të Skemës së Ndihmës Sociale, detyrat dhe obligimet e Zyrës së Punësimit si dhe të papunëve, dhe rëndësia e deklaratës së papunësisë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka vazhduar implementimin e programeve dhe projekteve aktive në tregun e punës. Në këtë mënyrë, MPMS-ja në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), po zbaton projektin në tregun aktiv të punës për gjenerimin e vendeve të punës, ku 207 janë të angazhuar në skemat e punë-kërkuesve, trajnime në punë dhe praktikë në punë. Me mbështetje nga Agjencia Federale Gjermane e Punësimit dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe Agjencisë Federale të Punësimit, u përzgjedhën 179 studentë për punësim të ndërmjetësuar në Gjermani. Në bashkëpunim me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), u punësuan 120 punëkërkues si punëtorë krahu me kontratë 1-vjeçare - me mundësinë e zgjatjes së saj.

Sa i përket kornizës legjislative të sektorit të shëndetësisë, Ligji Nr 04/L-150 mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësor u miratua nga Kuvendi në 30 maj të vitit 2013. Në mënyrë që të përmbushë legjislacionin e shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë (MSH) gjatë periudhës raportuese ka miratuar dy Udhëzime Administrative (UA), siç janë: Udhëzimi Administrativë Nr. 09/2013 mbi Skemën Nxitëse të Performancës së Profesionistëve Shëndetësorë dhe Shërbimeve Profesionale dhe Udhëzimi Administrativë Nr 08/2013 mbi Listën dhe Çmimoren e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Themelor.

Në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas (RAE) dhe komunitetet e tjera, në mes të majit dhe gushtit të vitit 2013 nga komuniteti RAE janë testuar 18 raste, ku janë marrë 13 mostra të gjakut kapilar dhe 17 mostra të gjakut venoz. Janë vaksinuar gjithsej 1,050 fëmijëve të komunitetit RAE. Zbatimi i projektit metadon është në vazhdim e sipër, deri më tani kanë përfituar 87 pacientë të moshave mes 20-56 vjeç.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, janë nënshkruar kontratat e para **me gjashtë Qendra** Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet rajonale.

### **3.1.8. Arsimimi dhe Hulumtimi**

Është miratuar legjislacioni i nevojshëm sekondar për zhvillimin profesional të mësimdhënësve:

- Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 16/2013 për zhvillim profesional të mësimdhënësve;
- Udhëzimi Administrativ (UA) mbi Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve.

Sa i përket sigurimit të cilësisë në sektorin e arsimit, ka filluar aplikimi i programit për trajnimin dhe licencimin e mësimdhënësve. Përkitazi me këtë, janë licencuar gjithsej 20,350 mësimdhënës në mes të qershorit dhe gushtit të vitit 2013. Janë akredituar pesë programe të trajnimit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve kështu duke krijuar mekanizma të trajnimit fillestar përmes programeve të USAID-it dhe GIZ -it.

Sa i përket hulumtimit dhe inovacionit, mbështetja financiare në formën e bursave u është vazhduar 35 kandidatëve për doktoraturë në këtë periudhë raportuese

## **3.2. POLITIKAT SEKTORIALE**

### **3.2.1. Industria dhe NVM-të**

Sa i përket përmirësimit të qasjes në financa për NVM-të, studimi i fizibilitetit për Skemën e Garantimit të Kredive (SGK) është përfunduar në qershor të vitit 2013. Për më tepër, Skema për Garantimin e Kredisë është krijuar me ndihmën e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Zyrës zvicerane. Përmes projektit të IPA-së 2013 të financuar nga Komisioni Evropian (KE), është krijuar një fond prej 3 milion euro për subvencionimin e NVM-ve 2.25 milion Euro të financuara nga KE-ja, dhe

0.75 milion euro të financuara nga MTI).

Programi "Internshipi në Biznese" është zhvilluar gjatë periudhës raportuese, dhe përfshinë një numër të përgjithshëm prej 185 nxënësve që kanë përfituar nga praktika.

Sa i përket promovimit të investimeve dhe eksportit, brenda periudhës raportuese, një numër i konferencave dhe forumeve promovuese ndërkombëtare të tilla si: Panairi Ndërkombëtar i Kompanive në New York, promovimi i potencialeve investuese në Kosovë të prezantuar në Iova, SHBA dhe në Futurallia në Turqi, janë ndjekur nga IPAK.

### **3.2.2 Bujqësia dhe peshkataria**

Lidhur me përfundimin e kornizës ligjore në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, Kuvendi i Kosovës ka miratuar draft ligjin mbi Blegtorinë, që është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 25/08/2013. (Ligji mbi blegtorinë Nr. 04 / L-191).

Në mënyrë që të plotësoj legjislacionin parësor me atë sekondar, gjatë kësaj periudhe, MBPZHR-ja ka miratuar këto Udhëzime Administrative:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 - Për organizimin, përgjegjësitë, të drejtat dhe obligimet e shërbimeve këshilluese të nivelit qendror dhe lokal, data 04/23/2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 - mbi regjistrimin e kultivuesve të rrushit, prodhuesve të verës dhe produkte të tjera të rrushit dhe verës, data 15/04/2013
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2013 - mbi standardet dhe pasurimin e miellit, siguria dhe kontrollimi i cilësisë së pasurimit të miellit, data 02.08.2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2013 - mbi uniformat, emblemat, kartat identifikuese dhe mbajtja zyrtare e armëve zyrtare, data 27/06/2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2013 - mbi detyrat, përgjegjësit dhe përbërjen e komitetit për bujqësinë organike, data 22/07/2013;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2013 - mbi përcaktimin e çmimit për shërbimet e kontrollimit të performuara në laboratorin KAI në Pejë, Nr. 07/23/2013

Sa i përket hartimit të politikave, planeve dhe programeve zhvilluese për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, gjatë kësaj periudhe, vlerësimi i zbatimit të Programit për Zhvillimin Bujqësorë dhe Rural për vitin 2012 është miratuar nga ana e Komisionit Monitorues më datën 27/06/2013, bazuar në Rregulloren e BE-së (KE) 1974/2006.

Sa i përket sektorit të verës, MBPZHR-ja ka përfunduar klasifikimin dhe certifikimin e verërave për vitin 2013 (prodhimi i verërave të vitit 2012). MBPZHR-ja ka certifikuar 64 lloje të verërave, prej të cilave 13 varietete (lloje) janë vlerësuar si kulmore; 35 janë vlerësuar si cilësore, 14 janë renditur si verëra tryeze dhe dy varietete të verave janë refuzuar.

Duke synuar konsolidimin e tokës, deri më tani, sipas raportit të kompanisë zbatuese të projektit "sh.p.k Intershped CA" në bazën Excel-it dhe sistemin e Acces-it janë futur 2,963 ha, në katër zona kadastrale të Komunës së Gjakovës. Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar puna për përditësimin e regjistrit të fermave, përderisa në sistem janë futur 25,610 fermer.

Në mënyrë që të ndaloj ndërrimin e përdorimit të tokës së punëshme, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 23 takime me zyrtarët përgjegjës të Departamentit për Planifikimin Hapësinor, Departamentin e Inspektoratit, dhe Drejtoritë e Bujqësisë të Kuvendeve Komunale. MBPZHR-ja gjithashtu ka dhënë pëlqimin për ndërrimin e përdorimit në 5 raste, ndërsa 6 raste janë kthyer prapa në Kuvendet Komunale për kompletim të dokumentacionit.

MBPZHR-ja përmes skemës së Grandeve është duke e bërë zbatimin e programit në vitin 2013 për Masën 2 (Re-strukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural) ; Masa 3 (Ujitja e tokës bujqësore); Masa 4 (investimet në përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore) dhe Masa 8 (Mbështetje për zhvillimin e komuniteti lokal).

Për këto katër masa kanë aplikuar 3,852 kandidat në Agjencinë e Zhvillimit Rural, të cilët janë duke u rishikuar nga Komisioni. Duhet të bëhet e ditur, se pagesat e subvencioneve prej 5.8 milionëve për grurin janë kryer, përderisa aplikacionet e tjera për subvencione dhe grande janë duke u kontrolluar.

Shuma e projekteve të propozuara është 104,233,520.89 Euro, për Masa dhe Sektor të ndryshëm siç shihet më poshtë në tabelën 18.

Tabela 18: Sektorët, numri i aplikantëve dhe shuma e projekteve

Nr.	Sektorët dhe masat (2,3,4,8)	Nr. i aplikuesve	Kostoja e projekteve
1.	Hortikultura dhe vitikultura	59	722,842.67
2.	Infrastruktura në vitikulturë	1	2,275.00
3.	Produktet jo-drunore	11	1,263,532.00
4.	Sektori i qumështit	445	19,844,867.15
5.	Sektori i vezëve	39	2,187,133.80
6.	Sektori i mishrave të viçit dhe pulave	82	4,071,677.38
7.	Sektori i bletarisë	249	3,011,181.23
8.	Prodhimi i qumështit	24	4,938,006.04
9.	Mishi dhe përpunimi i mishit	16	6,968,866.62
10.	Sektori i përpunimit dhe marketingut	58	8,480,200.92
11.	Ujitja e tokës	100	3,724,695.86
12.	Grupet Lokale të Veprimit (GLV)	39	835,849.00
13.	Sektori i perimtarisë - serrat	815	18,365,078.78
14.	Sektori i frutave	336	7,558,024.09
15.	Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekësore	100	881,686.89
16.	Frutat e buta (luleshtrydhet, manaferrat, dhe	336	3,143,541.52
17.	Perimet në fusha të hapura	175	600,231.9
18.	Mekanizimi bujqësor për lëvrim të tokës	609	11,515,196.72
19.	Mekanizimi i bujqësisë	238	4,295,595.98
20.	Mbështetja për prodhimin e qumështit	73	1,442,834.09
21.	Ripërtypësit - dele	15	338,026.35
22.	Ripërtypësit - dhitë	4	42,176.90
	<b>Totali: (kandidatët dhe kostoja e projekteve për projekte të ndryshme)</b>	<b>3,852</b>	<b>104,233,520.89</b>

MBPZHR-ja për vitin 2013 ka ndarë buxhetin për subvencionet dhe grandet në shumën prej 27 milion Euro, megjithatë, sipas tabelës më lartë kërkesat e fermerëve bazuar në projektet e tyre janë rreth pesë herë më të larta.

Sa i përket sektorit të pylltarisë, në mënyrë që të mbroj pyjet, Inspektorati Qendror i Pylltarisë (APK) gjatë periudhës prill-qershor ka kryer 310 kontrollime. AKP-ja dhe Kuvendet Komunale kanë ndërmarr këto veprime që janë paraqitur në tabelë.

Tabela 19: Veprimet e marra nga APK-ja dhe Komunitat

Numri i kontrolleve	Nr. i protokollit	Nr. i vendimeve të lëshuara	Nr. i fletëparaqitjeve për	Nr. fletëparaqitjeve e penale
<b>310</b>	<b>141</b>	<b>20</b>	<b>925</b>	<b>548</b>

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve të fermerëve, MBPZHR-ja së bashku me Kuvendet Komunale, ka ofruar këshilla të ndryshme për 4,555 fermerë mbi: mbushjen e aplikacioneve, grandeve, subvencioneve dhe projekteve kapitale, ndërsa për mbrojtjen e tokës bujqësore janë mbajtur 12 takime me qytetarë në 12 komuna. Në lidhje me rëndësinë e pyjeve dhe mbrojtjen e tyre, APK-ja ka organizuar 3 punëtori në Prishtinë më të gjitha palët e interesuara.

Në kuadër të Programit TAIEX, MBPZHR-ja ka dorëzuar 13 kërkesa për ekspertizë, dhe 34 kërkesa për vizita studimore. Me qëllim të promovimit të prodhimit bujqësor dhe bulmetit, MBPZHR-ja organizoi

"Ditën Ndërkombëtare të Qumështit" (1 qershor) ndërsa në datat 4-8 qershor MBPZHR-ja organizoi "Javën e luleshtrydheve dhe mjedrave". Në qershor, Kosova morri pjesë në kampionatin e lëvrimit që ishte mbajtur në Kanada

### Siguria e Ushqimit

Sa i përket zhvillimit të politikave dhe planeve për sigurinë e ushqimit, shëndetin e bimëve dhe kafshëve, plani zyrtar për kontroll dhe mostrimit të ushqimit dhe shëndetit të kafshëve për vitin 2013 është adoptuar më datën 12.02.2013 dhe zbatimi i tij i ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe (Prill-Qershor). Me qëllim të licencimit të tregut të kafshëve, Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit ka filluar të kontrolloj 5 (pesë) tregje të kafshëve në Lipjan, Vushtrri, Ferizaj, Istog dhe Pejë. Gjithashtu kategorizimi i Pikave të Kontrollit Kufitar është realizuar gjatë qershorit, si dhe Procedurat Standarde të Operimit për mostrimin e mishit dhe produkteve të tij, sipas kriterit Mikrobiologjik, janë miratuar në Qershor të vitit 2013.

AVUK ka vazhduar të forcojë kontrollin e prodhimeve bujqësore nga vendi si dhe atyre të importuar nga jashtë. Mostrat e marra nga inspektorët fito-sanitar në kufi dhe brenda shtetit, si dhe mostrat e inspektorëve sanitar janë dërguar për analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike në Institutin Bujqësorë të Pjesë, Institutin Kombëtar për Shëndetin Publik, Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe laboratorët jashtë Kosovës.

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë kësaj periudhe analizoi të gjitha mostrat e dyshuara të cilat janë pranuar nga klinikat veterinarë të kontraktuara nga AUV-ja dhe mostrat të cilat janë marrë nga inspektorët e AVUK-së, brenda planeve kombëtare në lidhje me kontrollin e ushqimit, si dhe projekteve sipas Memorandumit të Bashkëpunimit me MBPZHR-në, AUV-në, dhe LPV-në.

Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, gjatë periudhës raportuese AVUK punësoi: 3 inspektorë sanitar, 3 Inspektorët fitosanitar, 1 inspektor veterinar dhe 1 Zyrtar të Lartë Ligjor.

Përveç kësaj, 20 Inspektorët janë trajnuar për të kryer kontrollet zyrtare të AUV-së. Stafi i laboratorit është trajnuar për kryerjen e analizave të qumështit dhe drithërave, për aflatoksinë. Katër zyrtarë nga laboratorit u trajnuan në Breshia (Itali) për analizën e mbetjeve veterinarë në ushqim me metodat konfirmuese si dhe analizat bazike mikrobiologjike për ushqimin dhe për vlerësimin e rrezikut biologjikë dhe kimikë. Dhjetë pjesëtar shtesë të personelit të laboratorit janë trajnuar në laboratorët e ushqimit në Kosovë nga ekspertët në zbulimin aflatoksines.

Gjatë këtyre tre muajve (Prill-Maj), inspektorët e AUVK-së kanë lëshuar në total 11 fletëparaqitje për kundërvajtje për kompani të ndryshme që nuk kanë mundur t'i plotësojnë kërkesat e caktuara.

Të gjitha të dhënat për I & R (lëvizjen e kafshëve) si dhe analizat e mostrave të cilat janë kryer nga Laboratori i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Instituti Bujqësorë në Pejë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, dhe instituteve jashtë vendit. Mostrat janë marr nga Inspektorët Fito-sanitar (inspektorët e brendshëm dhe ata në kufi); Inspektorët veterinar (atyre të brendshëm dhe atyre në kufi) dhe inspektorëve sanitar (brenda Kosovës) dhe rezultatet e testeve janë prezantuar në tabelat e paraqitura në Aneksin 7: Të dhënat e sigurisë së Ushqimit

### **3.2.3 Mjedisi**

MMPH-ja ka vazhduar procesin e përfundimit të kornizës ligjore duke e adoptuar Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi përdorimin dhe menaxhimin e kondominiumit të Ndërtesave dhe Ligji mbi Planifikimin Hapësinor, të dyja të miratuara nga Kuvendi më 1 Gusht të vitit 2013.

Në mënyrë që të plotësoj legjislacionin primar me atë sekondar, gjatë kësaj periudhe, MMPH-ja ka miratuar këto Udhëzime administrative:

- UA Nr. 05/2013 për menaxhimin e vajrave dhe mbeturinave të vajrave (21 Mars, 2013);
- UA Nr. 04/2013 mbi shenjën për mbrojtjen e natyrës (20 maj, 2013);
- UA Nr. 05/2013 mbi llojin, paraqitjen dhe mënyrën e dhënies së Mirënjohjeve dhe Shpërblimeve për arritje në fushën e mbrojtjes së natyrës (20 Maj, 2013)
- UA Nr. 08/2013 mbi punët ndërtimore për të cilat nuk kërkohet një leje e ndërtimit (22 Maj, 2013);

- UA Nr. 09/2013, mbi kategorizimin e punëve ndërtimore (22 maj, 2013);
- UA Nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore si dhe për leje ndërtimore (04 Qershor, 2013);
- UA Nr. 11/2013, për përcaktimin e kërkesave teknike dhe kërkesave tjera për qeset e plastikës (05 qershor, 2013);
- UA Nr. 12/2013 mbi sistemin e informativ uJOR (17 Qershor 2013);
- UA Nr. 13/2013 Për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave (24 Qershor 2013);
- UA Nr. 14/2013, për mënyrën e hartimit dhe zbatimit të studimit për vlerësimin e rrezikut nga futja ,rifutja dhe kultivimi i llojeve të egra (1 qershor 2013)
- UA Nr. 16/2013 vlerat kufitare për përqendrimin e komponentëve të rrezikshme në mbeturina (12, korrik 2013)
- UA Nr. 17/2013 mbi kadastrën e Ndotësve të Mjedisit (06 Gusht, 2013);
- UA Nr. 18/2013 mbi standardet dhe procedurat minimale për Inspektimin, Mbikëqyrjen dhe lëshimin e Certifikatave të banimit (06 Gusht, 2013).

Sa i përket hartimit të politikave, planeve dhe programeve të zhvillimit për sektorin e mjedisit, gjatë kësaj periudhe, qeveria ka miratuar “Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022” si dhe “Planin e Veprimit të Kosovës mbi Mjedisin” (Vendimi Nr. 05/140 me datën 17.07.2013), dhe “Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Kualitetin e Ajrit” (më 07.08.2013)

Sa i përket zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë kësaj periudhe inspektorati i MMPH-së si pjesë e veprimit për të zbatuar vendimin e qeverisë “Për të ndaluar eksploatimin e rërës dhe zhavorrit në lumenj, shtretër të lumenjve dhe në hapësirat përreth brigjeve të tyre” ka kryer veprime të vazhdueshme dhe ka bërë 4 inicime penale.

Më 24 prill të vitit 2013, kryeministri ka nënshkruar 16 vendimet për shpalljen e zonave të mbrojtura për burimet e ujit të pijshëm, për: ujëmbledhësin në Radoniq, burimet, Istogu, Vrella, burimi Goci, Lipovica dhe Livadhet, burimet Shkoza-Junik, burimi “Drini i Bardhë”, burimi “Uji i Zi”, burimi “Uji i Bardh”, galeria dhe kanali për drenazh – në Pejë, Badovci dhe ujëmbledhësi i Batllavës, burimi Baja, ujëmbledhësi në Përlepnice, , Burimi “Guri i Hoxhës” - në Gjilan, burimi “Letnica”, burimi “Agai”, burimi “Përroi i Sylës”, “Përroi i Pukës” dhe lumi i vogël-në Ferizaj.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, 16 zyrtar nga MMPH-ja janë angazhuar me ekspert të projektit të binjakëzimit “Mbështetja institucionale për MMPH-në”-gjithashtu në kornizën e këtij projekti 5 zyrtar janë trajnuar mbi “ Menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave” (13 deri më 17 maj, Francë) dhe 4 zyrtar kanë marr pjesë në trajnimin “Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore mbi lëshimin e lejeve dhe zbatimi në nivelin qendror dhe lokal” (17-21 Qershor, Itali). Përveç këtyre, 6 zyrtar nga janë trajnuar në Budvë të Malit të Zi për “Krimet Mjedisore” dhe “Menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve” nga 27 deri më 30 maj të vitit 2013.

Në kuadër të aktiviteteve të Agjencisë Evropiane të Mjedisit, 11 zyrtarë janë përfshirë në trajnime dhe punëtori të ndryshme gjatë periudhës Maj-Qershor të vitit 2013 lidhur me cilësinë e ajrit dhe lirin e gazrave, raportimin elektronik të cilësisë së ajrit (e-raportimi), trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe adaptimi i ndryshimeve klimatike.

Në mënyrë që të ngritet kapaciteti në nivel komunal, MMPH-ja më 25 qershor të vitit 2013, ka organizuar trajnimin për zbatimin e legjislacionit mjedisor me temën “Paneli Tematik Mjedisor”

Për më tepër, një numër i zyrtarëve i nivelit komunal prej 30 komunave përgjatë Kosovës, janë përfshirë në punëtoritë për ngritjen e vetëdijes për zyrtarët komunal dhe komunitetin sa i përket trajtimin të vendbanimeve jo-formale (Prill dhe Maj të vitit 2013). Gjithashtu, në komunat e Prizrenit, Ferizajt gjatë periudhës Qershor-Gusht të vitit 2013, janë mbajtur trajnime për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane.

Megjithatë, në bashkëpunim me AKMM-në dhe shoqërinë civile, aktivitete të ndryshme janë organizuar për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Ujit, Ditën ndërkombëtare të Meteorologjisë



dhe Ditën e Tokës. Në këto aktivitete OJQ-të e ndryshme (Ekolëvizja, SHUKOS, Paqja me natyrën, Ekovizioni dhe AKEA) kanë një rolë të madh në kryerjen e aktiviteteve të parapara nga MMPH-ja, AKMM-ja dhe Shoqëria Civile.

Lidhur me të dhënat për mbledhjen dhe synimet e faturimit në sektorin e ujit dhe ujërave të zeza si dhe ndarjen e sektorëve, ato janë si vijon më poshtë:

- Të dhënat e faturimit - arritja e synimeve për periudhën Janar-Qershor 2013 në krahasim me objektivat e aprovuara të faturimit për vitin 2013: Në nivel të përgjithshëm të sektorit, objektivat e faturimit janë arritur rreth 88% (nga 100% të miratuar për vitin 2013),
  - Për konsumatorët e ekonomive familjare, faturimi është arritur me 88%;
  - Për konsumatorët komercial, mbledhja e pagesës së faturimit është arritur me 96%;
  - Për klientët institucional, realizimi i faturimit është arritur për 72%;
- Mbledhja e të dhënave - arritja e synimeve për periudhën Janar - Qershor të vitit 2013 në krahasim me objektivat e miratuar të mbledhjes për vitin 2013: Në nivel të përgjithshëm të sektorit është arritur 63% e mbledhjes nga 75% e miratuar për vitin 2013.,
  - Për konsumatorët e ekonomive familjare, 57% nga 66% aprovuar për vitin 2013 është arritur;
  - Për konsumatorët komercialë, 70% nga 89% aprovuar për vitin 2013 është arritur;
  - Për klientët institucional, 86% nga 97% aprovuar për vitin 2013 është arritur.

### 3.2.4. Politikat e transportit

Sa i përket zhvillimeve të legjislacionit primar në fushën e transportit, më 16 maj të vitit 2013, Ligji mbi Transportin Rrugor (Politikat Shoqërore dhe rregulloret për orët e vozitjes janë të inkuorporuara) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës (dekreti Nr. 027-2013 DL-, më 31 Maj të vitit 2013). Sa i përket përfundimit të kornizës dytësore ligjore në fushën e transportit hekurudhor, më 20 qershor të vitit 2013 MI-ja ka miratuar dy UA-të vijuese:

- U.A Nr. 02/2013 për llogaritjen e kostove të drejtpërdrejta ose mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore
- U.A Nr.03/2013 për vendosjen, caktimin dhe mbledhjen e tarifave për qasjen në infrastrukturën hekurudhore.

Në kontekstin e zhvillimit të aviacionit civil, në qershor të vitit 2013 është përmbyllur një marrëveshje për Zbatim në mes të Qeverisë së Hungarisë dhe Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë së Kosovës (KFOR) për ofrimin e shërbimit të navigimit të ajrit dhe aktiviteteve të tjera përkatëse në hapësirën ajrore të Kosovës. Si rezultat i kësaj, periudha e synuar për ri-hapjen e hapësirës ajrore të Kosovës, është gjysma e parë e vitit 2014. Për më tepër, në mënyrë që të adresoj prioritetet në pajtueshmëri me kornizën institucionale dhe me përgjegjësit, më 7 maj të vitit 2013 MPB-ja ka vendosur të plotësoj Programin Kombëtar për Sigurinë e Aviacionit Civil me ç`rast Doganave të Kosovës i është dhënë përgjegjësia për zbatimin e ligjit në aeroport. Sa i përket aktiviteteve operacionale në fushën e sigurisë së aviacionit civil, 5 inspektim janë duke u kryer në ANP "Adem Jashari" si dhe inspektimet në "Catering Prishtina" që është përgjegjës për furnizimin e aeroplanët me ushqim dhe pije. Për më tepër, Programi i Sigurisë për Linjat Ajrore Funktionale në Republikën e Kosovës është analizuar dhe miratuar më 31 korrik të vitit 2013 nga MPB-ja. Në anën tjetër, numri i udhëtarëve në ANP-në "Adem Jashari" gjithashtu ka vazhduar të rritet gjatë muajit Maj dhe Qershor, respektivisht, 16% dhe 7%. Si rezultat i dinamikës së përgjithshme të ngritjes deri në qershor ka pasur ngritje për 15 % në krahasim me periudhën e njëjtë gjatë vitit 2012.

Në fushën e sektorit të transportit hekurudhor gjatë periudhës raportuese ARH-ja ka pranuar Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë (SMS) dhe raportin vjetor të sigurisë nga TrainKos-i gjithashtu. Për më tepër, më 12 Gushtë të vitit 2013 RRA-ja i ka lëshuar autorizimin Trainkos-it për të vënë në shërbim një lokomotivë dhe dy trena me motor. Sa i përket aktiviteteve ndërkombëtare të bashkëpunimit, ARH-ja ka marrë pjesë në 31 takime plenare të Autoritetit Kombëtar të Sigurisë në trafikun Hekurudhor të mbajtur më 21-22 maj të vitit 2013 në Valenciennes të Francës.

Sa i përket sigurisë rrugore, kampanja për ngritjen e vetëdijesimit në shkollë është në vazhdim e sipër ku më shumë se 40 takime janë mbajtur me fëmijët e moshave të ndryshme dhe gjithashtu janë shpërndarë broshurat. Gjithashtu, Këshilli për Sigurinë e Trafikut<sup>2</sup> në Rrugë ka mbajtur një takim të rregull më 28 maj

të vitit 2013.

Në fushën e trafikut rrugor, zbatimi i projektit R7 është në rrugë e sipër, përkatësisht, pas përfundimit të segmentit (Morinë-Gjurgjicë), puna është duke vazhduar me të njëjtën dinamikë në segmentet 7-8-9 Prishtina **Jugore-Besi** (20km). Në ndërkohë, Këshilli drejtues ndërmënor ka miratuar dosjen e tenderit për projektin R6, përderisa Shërbimet Këshilluese të Transaksionit kanë përgatitur draft-kontratën. Si rezultat, Draft Kontrata dhe Dosja e Tenderit janë dorëzuar për tre kompanitë e para-kualifikuara për të ndërtuar autostradën R6 Prishtinë-Han i Elezit. Për më tepër, afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave do të jetë 45 ditë (java e tretë e shtatorit), ndërsa pritet që gjatë tetorit/nëntorit të nënshkruhet kontrata dhe të fillon zbatimi i projektit R6.

Sa i përket zbatimit të programit për mirëmbajtjen e rrugëve, rrugët kryesore dhe ato regionale mirëmbahen duke përfshirë autostradën R7. Ndërsa, nga 20 projektet e mbetura, gjashtë janë përfunduar (18.75 km të rrugëve janë ndërtuar).

Sa i përket sinjalizimit horizontal dhe vertikal të rrugëve, projekti është kryer 100%. Ndërkohë, 54 licenca janë lëshuar për transportimin e mallrave, 7 për transportimin e mallrave të rrezikshme dhe 10 licenca për transportimin e udhëtarëve.

Në kontekstin e aktiviteteve të inspektimit janë ndërmarrë masat e mëposhtme:

- 778 inspekte;
- 18 vendime për të larguar automjetet nga trafiku;
- 6 iniciativa për revokimin e urdhrave të udhëtimit për transportimin e udhëtarëve
- 31 vendime për të eliminuar parregullsitë, dhe
- 34 inicime të procedurave gjyqësore

Në fushën e ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, 125 shoferët për transportin e mallrave dhe 520 shoferëve për transportin e udhëtarëve janë trajnuar dhe certifikuar me CPC. Gjithashtu, 43 shoferët janë certifikuar dhe trajnuar me certifikatën e ADR për transportin e mallrave të rrezikshme. Ndërsa në fushën e sigurisë së hekurudhave, kryesuesi i departamentit të sigurisë ka kryer një trajnim tre-muajsh në ERA (Agjencinë Evropiane të Hekurudhave) nga 15 Prilli deri më 15 qershor të vitit 2013. Ndërsa në sigurinë e aviacionit civil, nga 27-31 maj i vitit 2013, dy inspektor të Sigurisë së Aviacionit Civil nga MPB-ja kanë marrë pjesë në programin "Auditimi i Sigurisë dhe Kontrolli i Cilësisë" i organizuar nga Shoqata ndërkombëtare e Transportit Civil (SHNTC) në Romë të Italisë. Si rezultat i kësaj, me këtë trajnim është përfunduar cikli i katërt i trajnimit ku inspektorët kanë marrë diploma nga SHNTC-ja në fushën e sigurimit të aviacionit civil. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese, 8 zyrtar nga ANP "Adem Jashari" janë trajnuar ndërsa më 15 qershor të vitit 2013 (Nr. 1721/2013) MPB-ja i ka certifikuar ata si operator të skanimit në ANP "Adem Jashari" Limak Kosova.

### **3.2.5. Energjia, përfshirë edhe sigurinë nukleare**

Gjatë periudhës maj-qershor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRSB) ka identifikuar dhe izoluar 9 burime radioaktive, ku që të gjitha janë rrufe pritës. Brenda periudhës raportuese AKMRSB-ja ka lëshuar 4 licenca dhe një autorizim, si në vijim:

- Më datën 14/05/2013, Instituti i mjekësisë së punës (IMP sh.a) i është lëshuar licenca për aktivitete me burime të rrezatimit jonizues (Nr. i protokollit 1215)
- Më datën 14/05/2013, Korporatës energjetike e Kosovës (KEK sh.a) i është lëshuar një licencë për aktivitete me burime të rrezatimit jonizues (Nr. i protokollit 1215);
- Më datën 29/05/2013 kompanisë EPE Kosova sh.p.k i është lëshuar një licencë për importimin dhe transportimin e burimeve radioaktive (Nr. i protokollit 1376);
- Më datën 29/05/2013, kompanisë EPE Kosova sh.p.k i është lëshuar një licencë për eksport dhe import të burimeve radioaktive;
- Më datën 29/05/2013, kompanisë Dobersek GmbH i është lëshuar një autorizim ngritjen e burimeve të rrezatimit jonizues (Nr. i Protokollit 1375).

Së bashku me projektet e raportuara në Inputin e Raportit të Progresit të majit të vitit 2013, KOSTT ka përfunduar zëvendësimin e izolatorëve, përcuesve<sub>3</sub> dhe pajisjeve lidhëse në 110 kV të linjës ajrore të

transmetimit 125/2. Linja e transmetimit është vënë me sukses në veprim më datën 30/03/2013. Si pjesë e kontratës për ndërtimin e linjës ajrore të transmetimit prej 400kV dhe kontrollit të frekuencës (LOT 2) në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, KOSTT ka nënshkruar një kontratë për realizimin e infrastrukturës së nevojshme për të realizuar kontrollin e frekuencës me anë të elektricitetit. Kontrata është nënshkruar më 14 qershor, të vitit 2013.

Në kuadër të zhvillimit institucional dhe fuqizimit të sektorit të energjisë. MTI-ja ka përdorur një transferim të brendshëm për të emëruar drejtorin e Divizionit për rezervat e detyrueshme të produktit të naftës. Në kuadër të planit të njëjtë të veprimit, një grup prej tre punëtorëve të KARPNS-së janë trajnuar në mbrojtjen ndaj rrezatimit dhe ekspozimeve mjekësore. Trajnimi, i cili është pjesë e projektit për zbatimin e sistemit dosimetrik të kontrollit dhe i cili financohet nga IPA, është mbajtur në Prishtinë nga 20 maj deri më 24 maj të vitit 2013.

### 3.2.6. Shoqëria Informative dhe Media

Në kontekst të kompletimit të kornizës primare ligjore, Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 4 tetor të vitit 2012. Sa i përket kornizës ligjore sekondare, me 21 qershor të vitit 2012 (Vendimi nr. 221) është miratuar rregullorja për llogaritjen e kostove sipas modelit Kostot e Shpërndara Plotësisht (KshP) nga Bordi i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)

Sa i përket krijimit dhe implementimit të politikave të përshtatshme për zhvillimin e shoqërisë informative, dokumenti strategjik "Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale për Kosovë 2013-2020" është miratuar nga Qeveria me Vendim Nr. 02/119 të datës 13 mars 2013. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës me 24 tetor 2012 ka miratuar vendimin (Nr. 04/88) për liberalizimin e mëtejshëm të shërbimeve të telefonisë mobile, ndërsa me 29 tetor 2012 ka miratuar vendimin (Nr. 01.89) për aprovimin e shenjës Z6 si shenjë e thirrjes për shërbime Radio Amatore në tërë hapësirën gjeografike të Republikës së Kosovës. Si rezultat i përfundimit të analizën e tregjeve për telefonin fikse dhe mobile, Bordi i ARKEP-it me 27 Mars 2013 ka miratuar fillimin e këshillimit publik të draft raportit të përgatitur nga Grupi Punues për analizën e tregjeve të linjave me qira dhe pas përfundimit të këshillimit pritet të hiqen obligimet në këto tregje për Ofruesit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT). Sa i përket zhvillimeve në fushën e radio frekuencave, plani i përdorimit të radio frekuencave është miratuar me 28 Shkurt 2013 nga Bordi i ARKEP-it si dhe njëkohësisht është hartuar plani për monitorimin e shfrytëzimit të radio frekuencave.

Sa i përket zhvillimeve në fushën e interoperabilitetit për ndërveprueshmërinë e sistemit të TIK, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Korniza e Interoperabilitetit me 13 shkurt 2013 me nr. 08/115.

Sa i përket zhvillimeve institucionale në fushën e medieve, në kuadër të procesit të kompletimi të emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), Kuvendi i Kosovës me 10 shkurt 2013 ka emëruar edhe një anëtarë të KPM, nga radhët e komunitetit serb duke emëruar 6 nga 7 anëtarët që duhet të ketë KPM. Ndërsa me 5 nëntor 2012, Kuvendi i Kosovës zgjodhi 3 anëtarë e Bordit për Ankesa të KPM.

Sa i përket vendimeve dhe rekomandimeve të lëshuara gjatë periudhës raportuese, KPM ka marrë 33 vendime ndaj subjekteve transmetuese. Nga këto, 14 vendime për licencim, 5 vendime për ndryshimin e emrit, 6 vendime për refuzim të kërkesave, 3 vendime për ndryshimin e lokacionit, dhe 3 vendime për raste ligjore - shkelje e Ligjit të KPM. Gjithashtu KPM ka marrë vendim të publikojë listën me frekuenca të lira për radio dhe TV lokale.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e TIK-ut, janë realizuar një numër aktivitete nga ARKEP-i drejt pjesëmarrjes në trajnime dhe vizita të ndryshme si me poshtë:

- Dy zyrtarë nga ARKEP-i kanë vazhduar vijimin e Trajnimit të Shkollës Rregullatorë pranë Shkollës Evropiane për Rregullatorë të Telekomunikacionit të organizuar nga Rober Schuman Center for Advanced Studies në Firence të Italisë (15 -19 tetor 2012; 6 - 8 dhjetor 2012; 14 - 16 shkurt 2013; 18 - 20 prill 2013);
- Tre zyrtarë nga ARKEP kanë marrë pjesë në trajnimin për ekspozimin ndaj valëve elektromagnetike prej, në Gjermani (4 - 6 mars 2013);

- Dy zyrtarë të ARKEP kanë marrë pjesë në Panairin ndërkombëtar CeBiT në Hanover të Gjermanisë (7 - 8 mars 2013);
- Tre zyrtarë të administratës së ARKEP kanë marrë pjesë në trajnimin për Financa në Dubrovnik, Kroaci (28 - 31 mars 2013);
- Vizitë studimore e ARKEP-se rreth autorizimeve të përgjithshme dhe regjistrimit për mbikëqyrjen e tregut në Riga, Letoni (pjesëmarrës tre zyrtarë, 22 - 24 janar 2013);
- Tre zyrtarë të ARKEP kanë marr pjesë në punëtorin e Ekspertit të TAIEX (eksperti nga Belgjika: Z. Jan Vannieuwenhuysen BIPT, Belgjik) rreth përgatitjes së rregullores për rregullat e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (28 janar deri me 1 shkurt 2013)
- Tre zyrtarë të ARKEP kanë marr pjesë në vizitën studimore për Monitorimin e Spektrit Frekuencor në Riga, Letoni (11 - 13 mars 2013); dhe
- Katër zyrtar të ARKEP-it kanë marr pjesë në vizitën studimore sa i përket rishikimit të rregullores për çmimet e spektrit frekuencor, Mision i Ekspertit nga TAIEX-i (2 ekspertë/trajnerë, Lituani (18 - 22 mars 2013).

Ndërsa, gjatë periudhës raportuese, një zyrtar i KPM nga 20 - 23 shkurt 2013 ka marr pjesë në trajnim për fushën e prokurimit publik dhe marrëdhëniet me publikun, në Tiranë, Shqipëri.

### 3.2.7. Kontrolli financiar

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve për kontrollin financiar dhe auditimin e brendshëm 74 zyrtarë kanë marrë pjesë në një trajnim 10 ditor në programin e certifikimit ndërkombëtar "Kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik" Moduli IM2. Në përgjithësi janë certifikuar 78 auditorë pas përfundimit të trajnimit. Edhe 93 zyrtarët të tjerë të njëjstëve të auditimit të brendshëm kanë marrë pjesë në trajnimin për kontrollin e menaxhimit financiar në modulën e parë dhe të dytë.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka arritur marrëveshje për zbatimin e Skemës së re të Certifikimit e cila u nënshkrua me Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës. Ajo është duke u zbatuar nga korriku i vitit 2013. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin profesional të stafit të ZAP-së dhe në forcimin e funksionit të mbikëqyrjes së financave publike në përgjithësi.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditime rregullative për Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) për 89 organizata buxhetore dhe dy organizata jo-buxhetore. Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Kosovës është botuar. Janë botuar 11 auditime të menaxhimit për Analizën e Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik të cilat në një mënyrë mund të konsiderohen si një auditim i performancës. Në të njëjtën kohë është botuar edhe një auditim i performancës.

Raporti Vjetor i Auditimit të bankave komerciale për vitin 2012 është dorëzuar në Parlament dhe është botuar. Raporti vjetor i performancës (RVP) me pasqyrat e saj financiare vjetore të audituara është botuar.

### 3.2.8. Statistikat

Sipas zhvillimit të statistikave të biznesit në përputhje me nevojat e Kosovës dhe standardet e EUROSTAT-it, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përfunduar mbledhjen e të dhënave për projektin e transferimit të klasifikimit të aktivitetit ekonomik nga NACE Rev .1 në NACE Rev 2. Të dhënat nga 27,650 biznese janë mbledhur në këtë fushë (më shumë se sa është planifikuar fillimisht).

Lidhur me përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë, pyetësorin, udhëzimet dhe metodologjinë e regjistrimit të bujqësisë janë harmonizuar me metodologjinë e Eurostat-it dhe me nevojat e vendit. Përgatitja e dokumenteve të tjera për regjistrimin e bujqësisë u realizuan gjatë periudhës raportuese të tilla si: Materiali i trajnimit për regjistruarit, kontrollorët dhe mbikëqyrësit. Përveç kësaj, deri më tani më shumë se gjysma e hartave të zonave të regjistrimit janë shtypur për regjistrimin e bujqësisë.

Publikimet e mëposhtme statistikore dhe raportet janë lëshuar në periudhën raportuese:

- Në lidhje me zhvillimin e statistikave të biznesit dhe regjistrimit të bizneseve në fushën e statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare ku publikimi është bërë si në vijim: Raportet statistikore të ndërmarrjeve në Kosovë për T1 dhe T2 të vitit 2013; Statistikat për transportin dhe telekomunikacionin T1 dhe T2 të vitit 2013; Statistikat mbi hotelet në Kosovë për T1 2013; Bilanci i Energjisë në Kosovë T1 2013; Llogaritë e qeverisë për vitin 2012.

- Publikimet 3 mujore të Statistikave për Tregtinë e Jashtme (STJ) për periudhën prill, maj dhe qershor 2013.
- Publikimet 3 mujore të Statistikave të inflacionit (indeksi i çmimeve të konsumit) për prill, maj dhe qershor 2013, 2 statistika për tremujorin për inflacionin mbi Indeksit e Çmimeve të Importit (IÇI) dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për T1 2013;
- Në fushën e statistikave sociale, janë hartuar 6 botime të tilla si: Rezultatet e anketës nga Anketat e Buxhetit Familjar (ABF) për vitin 2012 Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) për gjashtë muajt e parë të vitit 2012, Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor për vitin 2012; Statistikat për gratë dhe burrat për vitin 2011; Statistikat e natalitetit për vitin 2012; Statistikat e mortalitetit për vitin 2012.
- Në fushën e statistikave bujqësore, janë hartuar këto botime: Tremujori i indeksit të çmimeve të prodhimit dhe çmimet në bujqësi, T1 dhe T2 të vitit 2013; Tremujori i indeksit të çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi, T1 dhe T2 të vitit 2013. Anketa e Ekonomive Familjare Bujqësore për vitin 2012; Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2010-2011; Fakte sipërfaqësore mbi Mjedisin në Kosovë për vitin 2012.
- Në fushën e TI-së dhe metodologjisë janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme: përfundimi i sistemit të bazës së të dhënave "Informatat e regjistrimit" për përhapjen dhe shkëmbimin e të dhënave statistikore; përfundimi i asistimit në Gjuhen Shqipe (përkrahja për përdoruesit e ndërfaqes në ueb faqen e Eurostatit në gjuhen shqipe); Konfigurimi i sistemit informativ për matjen e kohës (ai mat produktivitetin për gjenerimin e statistikave).
- Është hartuar draft raporti përfundimtar mbi korrupsionin dhe statistikat e krimit që kanë të bëjnë me bizneset në Kosovë për vitin 2012 nga (projekt i mbështetur nga UNDOC).
- Një draft raport analitik është përgatitur për këtë anketë mbi remitancat e vitit 2012 (projekt i mbështetur nga UNDP-ja).
- Sa i përket kapacitetit administrativ dhe trajnimeve gjatë periudhës raportuese ASK-ja ka rekrutuar nëntë punëtorë: dy pozita në fushën e TI-së, gjashtë pozita në fushën e gjenerimit të statistikave dhe një pozitë në administratë. Sa i përket trajnimit të zyrtarëve të ASK-së u mbajtën 25 trajnime, punëtori dhe seminare shumica prej tyre janë mbajtur në Luksemburg.

### **3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA**

#### **3.3.1. Azili, migracioni, politikat e vizave dhe menaxhimi i kufijve**

##### Azili dhe migracioni

Në mënyrë që të sigurohet një kornizë e duhur ligjore në përputhje me legjislacionin e BE-së, ligjet në vijim u miratuan rishitas nga Kuvendi, më 31 korrik 2013:

- Ligi për të huajt;
- Ligji mbi azilin;
- Ligji mbi shtetësinë.

Gjatë procesit të hartimit, institucionet e Kosovës kanë marrë parasysh dhe ka përfshirë rekomandimet e KE-së në lidhje me këto ligje.

Për më tepër, më 13 gusht 2013 Qeveria e Kosovës ka aprovuar Rregulloren e rishikuar për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe menaxhimin e Programit të Ri-integrimit. Kjo Rregullore gjithashtu përcakton rregullat për funksionimin e Departamentit të MPB-së për Ri-integrim.

Në nivelin e politikave, Strategjia e Migracionit dhe PV 2013-2018, si dhe Strategjia e rishikuar mbi Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe plani i veprimtari janë hartuar dhe do të miratohen në shtator të vitit 2013.

Përveç kësaj, Kodi i Etikës për zyrtarët që punojnë në fushën e migracionit dhe azilit u miratua në maj të viti 2013, me qëllim të vendosjes së rregullave, parimeve dhe normave mbi bazën e së cilës të gjitha zyrtarët e migracionit dhe azilit do të veprojnë për qëllim të nxitjes së cilësisë së punës dhe interesit publik të karakterizuar nga integriteti, ndershmëria, objektiviteti dhe paanshmëria në përmbushjen e detyrave të tyre.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka vazhduar me lidhjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e ri-pranimit. Republika e Kosovës, gjatë periudhës raportuese, ka nënshkruar marrëveshje ri-

pranimi me Republikën e Estonisë, Principatën e Lihtenshtajnit dhe Republikën e Kroacisë. Përveç kësaj, Kosova ka lidhur dhe pritet të nënshkruajë marrëveshje ri-pranimi me Italinë dhe Letoninë. Kur bëhet fjale për vendet transite, Kosova është në fazën e negociatave me Maqedoninë, ndërsa një përgjigje nga Turqia nuk është marrë ende.

Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet se Kosova ka propozuar projekt-marrëveshjet për ri-pranim me vendet e origjinës së azilkërkesve si Afganistani, Pakistani, dhe Bregu i Fildishtë.

Sa i përket bashkëpunimit në fushën e migracionit, DSHAM-ja dhe Departamenti për Ri-integrim kanë mbajtur një takim me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Danimarkës më 17 qershor. Për më tepër, u mbajt një takim me atashetë e migrimit nga shtetet anëtare, gjatë të cilit janë shkëmbyer raportet mbi numrin e personave të ri-pranuar dhe numrin e rasteve të pazgjidhura. Një takim tjetër i tillë me atashetë u mbajt më 26 korrik 2013. Është dorëzuar raporti i DSHAM-së për gjysmën e parë të vitit 2013, që përmban të dhëna në fushën e nënshtetësisë, të huajt, azilin dhe ri-pranimin.

Për më tepër, baza e integruar e të dhënave e DSHAM-së tani është plotësisht funksionale, dhe ofron një menaxhim të centralizuar të informacionit.

Lidhur me ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimeve, më 3 qershor është organizuar një trajnimi pesë-ditor nga Projekti i KE-së për punonjësit që merren me ri-pranim. Për më tepër, një TT (Trajnimi për Trajnerë) ka qenë i organizuar nga projekti i Binjakëzimit në të cilën morën pjesë 2 punonjës të DSHAM-së. Gjatë periudhës raportuese, janë organizuar tetë sesione trajnuese për stafin e DSHAM-së, për tema që lidhen me politikën dhe procedurat efektive dhe shërbimet konsullore, etj.

Në mënyrë që të sigurohet ri-integrimi i qëndrueshëm i personave të ri-pranuar janë ndarë 3,200,000 € për programin e ri-integrimit për vitin 2013. Së fundi, për statistikën mbi nënshtetësinë, lejet e qëndrimit për të huajt, kërkesave për azil, si dhe statistikën mbi ri-pranimin dhe ri-integrimin, ju lutem referojuni në Raportin e DSHAM-së janar-qershor 2013, Aneksi 9.

#### Menaxhimi i kufirit

Në fushën e menaxhimit të kufirit, siç rekomandohet nga Komisioni Evropian, ligjet në vijim u miratuan nga Kuvendi, më 31 korrik, 2013:

- Ligji i amendamentuar mbi Kontrollin e Kufirit Shtetëror;
- Ligji mbi bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit.
- Sa i përket bashkëpunimit dypalësh për menaxhimin e kufirit, gjatë periudhës raportuese janë lidhur marrëveshjet si më poshtë:
- Marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë mbi themelimin dhe funksionalizimin e qendrës së përbashkët të bashkëpunimit policor të nënshkruar më 16 prill 2013; Qendra është themeluar më 15 qershor të vitit 2013;
- Marrëveshje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë për themelimin e përbashkët të PKK-së në Stançiq/Belanovac, të nënshkruar më 24 qershor të vitit 2013;
- Marrëveshje për bashkëpunim reciprok dhe asistencë për çështjet e doganave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë, të nënshkruar më 25 qershor të vitit 2013.

Përveç kësaj, dy PKK të tjera të përbashkëta me Republikën e Shqipërisë, në Gllloboqic-Borje dhe Orqush-Orjosht u themeluan dhe u funksionalizuan më 29 qershor të vitit 2013.

Infrastruktura e TI-së, SMK-së, si edhe rrjeti i telefonisë fikse, Intranetit dhe radio-lidhjeve, janë plotësisht funksionale në të gjitha PKK-të. Përveç kësaj, sistemi ASYCUDA është gjithashtu plotësisht funksional në të gjitha PKK-të.

Me synimin për të luftuar në mënyrë sa më efektive krimin e organizuar ndër-kufitar, më 5 korrik 2013 u dhuruan pajisjet e avancuara për PKK-në si më poshtë: pajisje GPS, Garmin, Rino 650-60 BITS dhe Kamera Mbikëqyrjes pa tela Scouting HCO, UM652 - 180 copë. Përveç kësaj Njësia K9 ka filluar funksionimin më

1 korrik, 2013.

### Politika e Vizave

Republika e Kosovës ka prezantuar regjimin e vizave vis-à-vis vendeve të treta më 1 korrik të vitit 2013. Ky regjim vlen për 87 vende. Regjimi i vizave kërkon nga qytetarët e këtyre shteteve për t'u pajisur me vizë të Republikës së Kosovës në misionet tona diplomatike/konsullore para se të hyjnë në territorin tonë.

Më 8 maj 2013, Qeveria gjithashtu mori një vendim për të lejuar hyrjen, transit dhe qëndrimin e përkohshëm (deri në 90 ditë) të qytetarëve të BE-së në territorin e Republikës së Kosovës me një kartë të vlefshme të identitetit.

Sa i përket përgatitjeve teknike të nevojshme për **zbatimin regjimit** të vizave vis-à-vis vendeve të treta, Ministria e Punëve të Jashtme, ka themeluar Sistemin e Informacionit të Vizave të Kosovës. Ky sistem tashmë është instaluar në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stamboll, e cila, për gjashtë muaj, do të jetë misioni i vetëm Konsullor për lëshimin e vizave të Republikës së Kosovës, për qytetarët e huaj. Që nga 1 korriku i vitit 2013 ky sistem është funksional në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari' në të dy funksionet: lëshimin e vizave të jashtëzakonshme dhe leximin e vizave të zakonshëm, të lëshuar nga Konsullata e Përgjithshme në Stamboll.

### **3.3.2. Pastrimi i parave**

Gjatë periudhës raportuese, NJIF-ja ka përfunduar raportin e saj vjetor të vitit 2012. Raporti është në proces të përkthimit dhe do të shpërndahet po sa të përfundohet përkthimi. Ndërsa, sa i përket statistikave mbi pastrimin e parave, ju lutem referojuni Aneksit 9: Faqja "Krimi ekonomik dhe korrupsioni".

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve në luftën kundër pastrimit të parave, gjatë periudhës raportuese 8 zyrtarët të NJIF-së morën pjesë në 3 trajnime mbi shabllonin për unifikimin e raporteve penale dhe rimëkëmbjen e aseteve etj. Përveç kësaj, u zhvillua një takim me homologët sllovenë gjatë së cilit u diskutua anëtarësimi i Kosovës në Grupin EGMONT.

Për më tepër, gjatë periudhës raportuese, 2 gjyqtarë kanë ndjekur trajnimin specifik për pastrimin e parave. Ndërkohë, dy sesione trajnimi për hetimin dhe gjykimin e krimeve financiare janë ofruar për 27 pjesëmarrës (2 gjyqtarë, 4 prokurorë dhe 21 të tjerët).

### **3.3.3. Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, përfshirë terrorizmin**

Në mënyrë që të sigurohet një luftë e qëndrueshme kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Kosova ka ndërmarrë një numër të përpjekjeve në përmirësimin e kornizës ligjore dhe strategjike. Prandaj, këto ligje që rrjedhin nga procesi i liberalizimit të vizave janë miratua nga Kuvendi më 31 korrik të vitit 2013:

- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
- Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, dhe
- Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

Ndërsa korniza strategjike është konsoliduar në masë të madhe përmes rishikimeve të fundit të strategjive dhe planeve të veprimit, tani fokusi është zhvendosur drejt një monitorimi më sistematik të zbatimit të tij. Prandaj, raportet e monitorimit mbi zbatimin e kornizës së përmendur tani kanë përfunduar sa i përket tremujorit të dytë të vitit 2013. Në përmbledhje, raportet theksojnë këto në vijim:

**Lufta kundër trafikimit të drogës:** PK-ja ka intensifikuar punën e saj kundër trafikimit të drogës dhe posedimit. Puna efikase ka rezultuar me mungesën të ofertës së drogës në Kosovë, prandaj, sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet çmimi i 1 gr kanabis është më e lartë në Kosovë sesa në vendet e tjera të rajonit (me përjashtim të Malit të Zi)<sup>1</sup>. Për më tepër, MSH është duke punuar intensivisht në fushën e parandalimit dhe reduktimit të dëmit. Deri tani, kjo ministri ka hartuar dhe është duke monitoruar zbatimin e Planit Kombëtar për Parandalimin e Abuzimit me Drogën dhe trajtimin e varësisë. Për më tepër, programi Methadone është duke u zbatuar në 3 institucione

shëndetësore publike (në Prishtinë, Gjakovë dhe Gjiilan), OJQ Labyrinth klinika praktike dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës. Gjatë Periudhës Janar - Qershor 2013 ka pasur 118 persona që iu janë nënshtruar trajtimit me metadon. Statistikat mbi luftën kundër trafikut të drogës u janë referuar një seksion të veçantë më poshtë.

**Lufta kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar mbi çështjet penale:** bashkëpunimi i PK-së me agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit është duke përparua. Këtë vit PK-ja është pjesë e një operacioni të përbashkët me EUROPOL-in. Në një shënim të ngjashme, në prill të vitit 2013 DK u bë zyrtarisht pjesë e Sistemit të Informativë të Ballkanit, një mekanizëm për shkëmbimin e informacionit që përfshin homologët rajonalë. Për më tepër, Policia e Kosovës ka përfunduar raportin SOCTA (Vlerësimi i rrezikut nga krimet e rënda të organizuara) i cili së shpejti do të ndahet me EULEX-in dhe EUROP-in.

Policia e Kosovës ka ndërmarrë këtë vlerësim për herë të parë. Nga ana tjetër, ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë. Që nga maji i vitit 2013 është bërë një rekrutimi i ri në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, si edhe dy sesione trajnimi (duke mbuluar temën mbi lëvizjen e dëshmitarëve dhe leximi i hartave). Statistikat mbi luftën kundër krimit të organizuar janë përmendur në një seksion të veçantë si në vijim:

**Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe rehabilitimi i viktimave:** përveç një pune intensive në luftimin e TQNJ-ve, vëmendje e posaçme është duke ju kushtuar identifikimit të viktimave dhe procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit. Në këtë aspekt, procesi i licencimit të shërbimeve sociale dhe familjare për viktimat e trafikimit ka vazhduar deri më sot, janë licencuar 62 ofrues të shërbimeve të tilla. Në ndërkohë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave ka ofruar ndihmë ligjore për 17 viktimat e trafikimit. Statistikat e detajuara mbi trafikimin e qenieve njerëzore (TQNJ), (duke përfshirë identifikimin e viktimës) janë përmendur në një seksion të veçantë më poshtë.

**Parandalimi i krimit të organizuar:** Raporti i vlerësimit të kapaciteteve të PK-së për vitin 2012 nënvizon nevojën për 20 policë shtesë në kuadër të Drejtorisë së PK-së për Krimet Ekonomik dhe Hetimin e Korrupsionit. Është duke u zhvilluar procesi i brendshëm i rekrutimit të këtyre policëve. Nga ana tjetër, Departamenti i Operacioneve të PK-së i ka përditësuar 18 PSO në mënyrë që të bëjë procedurat operative më efikase.

**Lufta dhe parandalimi i terrorizmit:** në bazë të vlerësimit të rrezikut nga terrorizmi, aktualisht ekziston një kërcënim i ulët i terrorizmit në Kosovë. Megjithatë, palët kryesore të interesuara që janë përgjegjëse janë të angazhuar në mënyrë aktive në parandalimin e ndonjë radikalizim eventual apo paraqitjen e grupeve terroriste ndërkombëtare në Kosovë.

**Masat kundër-korrupsionit:** Plani i veprimit kundër-korrupsionit përcakton masa dhe indikatorë të qartë dhe identifikon institucionet kryesore përgjegjëse të mandatuara për të raportuar mbi aktivitetet e tyre në lidhje me përparimin në luftën kundër korrupsionit. Sipas raportit të parë të monitorimit, që mbulon periudhën shkurt-maj 2013, nga 154 masa, 40 janë zbatuar plotësisht. Për më shumë informacion mbi zbatimin e strategjisë kundër-korrupsionit, ju lutem referojuni Aneksit 10: 'Zbatimi i Strategjisë kundër-korrupsionit (KK) 2013'. Për statistika më të hollësishme mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin referojuni Aneksit 9, fleta 3 dhe 4.

Më në fund, për herë të parë, PK-ja ka sekuestruar dhe ka ngrirë pasurit e patundshme të të dyshuarve të fituara siç dyshohet nga një vepër penale.

Pasurit e patundshme të sekuestruar:

- Dy (2) apartamente prej 62 m<sup>2</sup>, që gjendet në Prishtinë;
- Një (1) Shtëpia prej 336 m<sup>2</sup> që gjendet në Lipjan.

Pasuritë e ngrira:

- Tre (3) apartamente në Prishtinë;
- Një (1) shtëpi prej 1000m<sup>2</sup> në Istog;
- 21, 000 EUR në dy banka në Kosovë;



- Një motel në magjistralen Prishtinë-Ferizaj (aktualisht nën mbikëqyrjen e AAPSK-së).

Gjithashtu, KPK-ja ka qenë shumë pro-aktiv në fushën e konfiskimit të aseteve, përkatësisht në lëshimin e urdhrave për konfiskim. Për më shumë informacion mbi urdhrat për konfiskim të lëshuar nga prokurorët e Kosovës, ju lutem shihni Aneksin 9 fletën "Konfiskim i aseteve".

### 3.3.4. Mbrojtja e të dhënave personale

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka përfunduar hartimin e legjislacionit sekondar përcjellës në lidhje me zbatimin e Ligjit për Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

- Rregullorja për transferimin e të dhënave personale në fushën e gjyqësorit dhe policisë ka hyrë në fuqi;
- Kodi i Etikës për zyrtarët e mbrojtjes së të dhënave personale aktualisht është në diskutim publik për komente;
- Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës ka kaluar të gjitha fazat dhe procedurat dhe ka hyrë në fuqi nga 1 gusht i vitit 2013;
- Rregullorja për inspektim në zyrat e prokurorëve, policisë dhe gjykatave është në përfundim;

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është konsultuar vazhdimisht në lidhje me pajtueshmërinë e legjislacionit në fushën e të dhënave personale. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka dhënë komente mbi 10 projektligje.

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë periudhës janar - gusht 2013 ka kryer aktivitete në institucionet e mëposhtme:

- Inspektim në NGB "Zeri";
- Inspektim në komunën e Mitrovicës;
- Inspektim në komunën e Skenderajt;
- Inspektim në SH.P.K. Zeri;
- Inspektim në komunën e Vushtrrisë;
- Inspektim në QPS-në e Lipjanit;
- Inspektim në Qendrën Mjekësore në Lipjan;
- Inspektim në Kolegjin "UNIVERSUM";
- Inspektim në Ambasadën e Kosovës në Shqipëri;
- Inspektim në SH.P.K "JUSK" dhe "PTK";
- Inspektim në Kolegjin "Illyria";
- Inspektim në SH.A "PTK";
- Inspektim në komunën e Gjilanit;
- Inspektim në komunën e Kamenicës;
- Inspektim në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Inspektim në ujësjellësit rajonal në Prishtinë;
- Inspektim në "VIVA" Fresh Store;
- Inspektim në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Inspektim në Njësinë e Inteligjencës Financiare;
- Inspektim në Ministrinë e Financave;
- Inspektim në Bankën BKT;
- Inspektim në Agjencionin Eurokoha;
- Inspektim në TEB Bank;
- Inspektim në SH.A CITY PARK;
- Inspektim në Fondin e Kursimeve Pensionale.

Përveç kësaj, gjatë periudhës raportuese AKMDhP-ja ka lëshuar këto vendime, rekomandime dhe opinione këshillimore:

- Vendimi për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale;
- Rekomandim për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Rekomandimi për komunën e Novobërdës; 40

- Rekomandim për Këshillin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave;
- Rekomandim për kompaninë Scan Colour JYSK në shkatërrimin e të dhënave të klientëve;
- Rekomandim për kompaninë e sigurimeve ILLYRIA mbi mbikëqyrjen e videove;
- Rekomandimi për Kolegjin VICTORY, për instalimin e sistemit të video mbikëqyrjes dhe vendosjen e njoftimeve;
- Rekomandim për Korporatën Energjetike të Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale të konsumatorëve;
- Rekomandimi për komunën e Vushtrrisë për instalimin e një sistemi të video mbikëqyrjes;
- Rekomandimi për komunën e Mitrovicës mbi vendosjen e shenjave të njoftimit të mbikëqyrjes përfshirë edhe shenjat e lajmërimit të mbikëqyrjes brenda hapësirave të punës së Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë;
- Rekomandim për Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë mbi përdorimin e karakteristikave biometrike në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rekomandim për Organin Shqyrtues të Prokurimit për kryerjen regjistrimet të hyrjeve dhe daljeve nga ndërtesa, në përputhje me nenin 69 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rekomandim për Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari' për shfrytëzimin e karakteristikave biometrike në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rekomandim për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në nxjerrjen e një akti të brendshëm mbi procedurat dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Rekomandim për Kompaninë Rajonale të Ujësllësit Prishtina mbi instalimin e sistemit të video mbikëqyrjes, si dhe përpunimin e të dhënave personale; Kompania Rajonale e Ujësllësit "Prishtina", u këshillua për të kryer regjistrimet e hyrjeve dhe dalje nga ndërtesa në përputhje me Nenin 69 të Ligjit mbi Mbrojtja e të dhënave personale;
- Rekomandim për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për shkatërrimin e të dhënave personale të personave që hyjnë dhe dalin nga ndërtesa. Ajo ishte këshilluar që të nxjerrë një akt të brendshëm mbi procedurat dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe për të marrë një vendim për të instaluar sistemin e video mbikëqyrjes;
- Rekomandim për Njësinë e Inteligjencës Financiare, për shkatërrimin e të dhënave personale të personave që hyjnë dhe dalin nga ndërtesa, ajo është këshilluar që të nxjerrë një akt të brendshëm dhe një vendim për instalimin e sistemit të video mbikëqyrjes.
- Rekomandimi për Bankën Kombëtare Tregtare për qasje në Regjistrin e Kredive të Kosovës pa pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave;
- Rekomandim për Euro-KohaReisen në shkatërrimin e të dhënave personale të klientëve;
- Rekomandim për "TEB" bankën në krijimin e një sistemi të monitorimit që mundëson mbrojtjen e të dhënave;
- Rekomandim për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në:
- Nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit me stafin e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale;
- Emërimin e personit përgjegjës për sistemin e dosjeve;
- Vendosja e njoftimi për sistemin e video mbikëqyrjes;
- Rekomandim për Bordin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialiteti me stafin e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale;
- Rekomandim për Agjencinë Qendrore të Prokurimit për nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit me stafin e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale;
- Rekomandim për Institutin për Administratë Publike për nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit me stafin e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale;
- Rekomandim për Ministrinë e Integritimit Evropian për nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit me stafin e autorizuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shumica e institucioneve publike dhe private kanë emëruar zyrtarë për mbrojtjen e të dhënave personale.